



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

RAPORTI VJETOR

2022

Prishtinë, 2023

RAPORTI VJETOR 2022

Përmbajtja

Përmbajtja.....	5
FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE	7
RAPORT VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2022	10
SEKRETARIATI I GJYKATËS KUSHTETUESE	12
NJËSIA LIGJORE.....	15
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE.....	19
DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT	31
DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE.....	43
DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCEVE	47
NJËSIA E PROKURIMIT	57
NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT KOMUNIKIMIT DHE MULTIMEDIEVE	59
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM	69
ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM	67
AKTIVITETET TJERA TË GJYKATËS KUSHTETUESE	79
SHTOJCA I	85
ORGANOGRAMI	97

FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në përmbushjen e detyrave të saj si gardian i Kushtetutës, gjatë vitit 2022 ka thelluar më tej konsolidimin e saj institucional, si dhe zhvillimin e praktikës së saj gjyqësore bazuar në vlerat dhe parimet demokratike e të sundimit të ligjit, siç burojnë nga normat kushtetuese, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Raporti vjetor për vitin 2022, shpërfaq në mënyrë të përmbledhur punën dhe aktivitetet e Gjykatës Kushtetuese përgjatë vitit të fundit, rezultatet e së cilës, sigurisht burojnë edhe nga të arriturat e viteve paraprake, si në kuptim të zhvillimit të praktikës gjyqësore po ashtu edhe në kuptim të zhvillimit institucional. Në këtë aspekt, edhe përkundër faktit që Gjykata deri në dhjetor të vitit 2022, kur është emëruar gjyqtari i radhës kishte funksionuar me vetëm shtatë (7) gjyqtarë përkundër dispozitave kushtetuese që përcaktojnë përbërjen e Gjykatës prej nëntë (9) anëtarësh, ka përmbushur me sukses objektivat dhe aktivitetet e planifikuara në planin vjetor të punës dhe të cilat janë prezantuar në detaje në këtë raport vjetor.

Raporti vjetor, në vazhden e praktikës së konsoliduar të kësaj Gjykate, ka për qëllim transparencën e plotë me publikun përkritazi me të gjitha aktivitetet e saj përgjatë vitit raportues. I njëjti pasqyron në mënyrë të përmbledhur të gjitha informacionet relevante lidhur me punën e Gjykatës dhe secilit departament të saj, përfshirë statistikën e nevojshme lidhur me kërkesat e pranuar dhe të zgjidhura, tipologjinë e shkeljeve kushtetuese të pretenduara para Gjykatës, aktivitetet administrative, vizitat zyrtare dhe punëtoritë e mbajtura, si dhe informata të detajuara përkritazi me menaxhimin e financave publike.

Për sa i përket vendimmarrjes, Gjykata vitin e kaluar ka pranuar gjithsej 220 kërkesa, ndërsa 145 prej tyre janë bartur nga vitet paraprake. Nga numri total i kërkesave të pranuar, 185 prej tyre janë parashtruar nga individët, 28 kërkesa janë parashtruar nga personat juridikë, përderisa 7 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet publike. Ndërkaq, në ueb-faqen e Gjykatës janë publikuar 170 vendime, prej të cilave 20 Aktgjykime, 134 Aktvendime për papranueshmëri, 11 Vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër, 2 Vendime për tërheqje të kërkesës, 1 Aktvendim për mospërmbarim dhe 2 Urdhra të tjerë. Numri në rritje të vazhdueshme i kërkesave të parashtruara, llojllojshmëria, si dhe ndërlikueshmëria në rritje e çështjeve të trajtuara, janë gjithashtu indikator i besimit në rritje të qytetarëve në punën dhe vendimmarrjen e Gjykatës.

Përtej aspektit statistikor, dëshiroj të vë theksin në faktin se gjatë vitit 2022, Gjykata ka formësuar dhe/ose konsoliduar më tej interpretimin e normave kushtetuese përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, duke përfshirë por mos u kufizuar në: (i) qartësimin e ndërveprimit të kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal; (ii) mbrojtjen e parimit të barazisë së qytetarëve para ligjit; (iii) mjetet efektive juridike dhe detyrimin e gjykatave të rregullta për të siguruar të drejtën për qasje në drejtësi lidhur me të drejtat e qytetarëve të garantuara me ligj; dhe (iv) interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në Kushtetutë dhe instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare, duke përfshirë në kontekst të detyrimeve pozitive të shtetit.

Në kontekst të qartësimit të kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal, Gjykata ka trajtuar për herë të parë që nga themelimi i saj në mënyrë më gjithëpërfshirëse parimet përkritazi me vetëqeverisjen lokale të përcaktuara me Kushtetutë, Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias. Përmes Aktgjykimit në rastin KO145/21, me parashtrues të kërkesës: Komuna e Kamenicës, dhe në kontekst të kompetencave përkritazi me ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm nga komunat, Gjykata ka riafirmuar, mes tjerash, parimet kushtetuese që theksojnë se: (i) njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë

komunat dhe se organizimi dhe kompetencat e tyre rregullohen me ligj; (ii) kompetencat që u besohen autoriteteve lokale normalisht duhet të jenë të plota dhe ekskluzive, dhe se ato nuk mund të minohen apo të kufizohen nga një autoritet tjetër, qendror apo rajonal përveç siç përcaktohet me ligj; dhe (iii) çdo kontroll administrativ mbi autoritetet lokale mund të ushtrohet vetëm sipas formave dhe në rastet e parashikuara nga Kushtetuta dhe/ose ligji. Parimet e njëjta u konfirmuan edhe në Aktgjykimin në rastin KO173/21, me parashtrues të kërkesës: Komuna e Kamenicës.

Për sa i përket mbrojtjes së parimit të barazisë së qytetarëve para ligjit, Gjykata përmes: (i) Aktgjykimit në rastin KO93/21, me parashtrues të kërkesës: Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës; si dhe (ii) KO190/19, parashtrues i kërkesës: Gjykata Supreme, ka konsoliduar më tej praktikën e saj gjyqësore në lidhje me barazinë para ligjit, përfshirë për sa i përket konceptit të dallimit në trajtim të qytetarëve: (i) përmes Rekomandimit të Kuvendit që parashihte mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike të konsumatorëve të energjisë elektrike që jetojnë në katër (4) komuna të Kosovës, por jo edhe për qytetarët e komunave të tjera; dhe (ii) përmes një Udhëzimi Administrativ që përcakton kriterin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar të përvojës së punës para vitit 1999 për të përfituar pensionin “kontribut pagues” të përcaktuar përmes Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Në kontekst të së parës, përkatësisht dallimit në trajtim të konsumatorëve të energjisë elektrike në katër (4) komuna të Kosovës, Gjykata gjeti se masa në fjalë mund të konsiderohej proporcionale, marrë parasysh: (i) natyrën e përkohshme të aktit përkatës të Kuvendit; si dhe (ii) respektimin e detyrimeve ndërkombëtare të shtetit për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike. Ndërsa në kontekst të rastit të dytë, Gjykata gjeti se masa në fjalë nuk mund të konsiderohej proporcionale, marrë parasysh që detyrimi që këtë kriter ta përmbushin edhe qytetarët të cilët gjatë viteve të '90-ta ishin larguar nga puna si rezultat i aplikimit të ligjeve diskriminuese të ish-Jugosllavisë, nuk mund të përbënte, “një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”.

Në anën tjetër dhe në lidhje me qartësimin dhe konsolidimin e praktikës gjyqësore në kontekst të shterimit të mjeteve juridike dhe detyrimit të gjykatave të rregullta për të siguruar të drejtën për qasje në drejtësi, Gjykata përmes Aktgjyqimeve në rastet: (i) KI10/22, me parashtrues të kërkesës: Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore; (ii) KI214/21, me parashtrues të kërkesës: Avni Kastrati; si dhe (iii) KI57/22 dhe KI79/22 (raste të bashkuara), me parashtrues të kërkesës: Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti, ndër të tjera, ka sqaruar se: (i) është detyrim i gjykatave të rregullta që të sigurojnë ruajtjen e supremacisë juridike të ligjeve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin e aplikueshëm, pasi një detyrim i tillë përpos që buron nga Kushtetuta, është po ashtu qartësisht i përcaktuar në Ligjin për Konfliktet Administrative; (ii) dekretet e karakterit individual të nxjerra nga Presidenti i Republikës, në parim dhe bazuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mund të kontestohen para gjykatave të rregullta për vlerësim të ligjshmërisë së tyre; dhe (iii) mjetet juridike të përcaktuara përmes Ligjit për Konfliktin Administrativ, në parim janë mjete efektive juridike dhe se rëndësia e një funksioni publik të mbajtur apo të synuar, nuk mund të qëndrojë si argument i vetëm dhe i izoluar, mbi bazën e të cilit mund të bëhet lirimi nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike para se parashtruesit t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Në fund dhe në kontekst të interpretimit të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në Kushtetutë dhe instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare, Gjykata, përgjatë vitit raportues, përtej konsolidimit të praktikës gjyqësore, gjithashtu ka zgjeruar të njëjtën edhe në kontekst të: (i) garancive dhe parimeve për të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, siç është garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe siç më detajisht sqarojnë rrethanat e Aktgjykimit KI19/21; dhe (ii) cenimit të së drejtës për jetë private të garantuar me nenin 36 [E drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës

private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si rezultat i përgjimeve të paligjshme dhe siç më detajisht sqarojnë rrethanat e Aktgjykimit KI113/21.

Duhet të theksohet që të gjitha vendimet e Gjykatës, përfshirë përmbledhjet dhe njoftimet përkatëse për publikun, janë të publikuara në ueb-faqen e Gjykatës në dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në gjuhën angleze, por përfshirë edhe ato franceze. Gjithashtu, të gjitha Aktgjykimet dhe Aktvendimet më të rëndësishme janë të përmbledhura dhe publikuara në Buletinet e Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese që publikohen në ueb-faqen e Gjykatës në baza mujore, tremujore dhe vjetore.

Krahas punës së bërë në shqyrtimin e lëndëve dhe nxjerrjen e vendimeve përkatëse përgjatë vitit raportues, Gjykata ka ndërmarrë dhe zbatuar një varg aktivitete të dizajnuara për të avancuar më tej kualitetin dhe efikasitetin e funksionimit të saj të brendshëm dhe përforcimin e mekanizmave për transparencë të avancuar dhe komunikim efektiv me publikun. Përgjatë vitit, bazuar në diskutimin e identifikimin e sfidave dhe mundësive, aktivitetet e saktësuara në Planin Strategjik për periudhën pesëvjeçare (2021–2025), por edhe analizave të shumta krahasimore, Gjykata, ndër të tjera: (i) i është nënshtruar dhe ka organizuar trajnime dhe diskutime tematike, edhe me mbështetjen e partnerëve të Gjykatës por edhe në bashkëpunim me gjykatat simotra, në fusha të ndryshme të kontrollit konkret, preventiv, abstrakt e incidental; (ii) ka realizuar një numër vizitash studimore e shkëmbime stafi me Gjykatat simotra me qëllim të shkëmbimit të përvojave në çështje me interes të përbashkët; (iii) në bashkëpunim me programet e mbështetura nga Këshilli i Evropës, ka mbështetur vendosjen e një numri të stafit të Gjykatës në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke u angazhuar drejtpërdrejtë edhe në trajtimin e rasteve të kësaj të fundit; (iv) ka avancuar më tej mekanizmat që sigurojnë kualitetin e hulumtimeve dhe analizave në kuadër të Njësisë Ligjore; (v) ka ndërmarrë një numër ndryshimesh strukturore me qëllim të ngritjes së efikasitetit të funksionimit organizativ; (vi) ka amendamentuar/hartuar rregullore të brendshme që ndërlidhen edhe me menaxhimin efektiv të rasteve, por edhe kualitetin e punës së departamenteve dhe menaxhimit të financave publike; (vii) ka avancuar më tej sistemet e teknologjisë informative; (viii) ka avancuar mekanizmat e komunikimit me publikun përkthazi me vendimmarrjen e saj; si dhe (ix) përmes aktiviteteve të ndryshme, përfshirë edhe vizitat protokollare, ka përforcuar më tej bashkëpunimin me gjykatat simotra, gjykatat ndërkombëtare dhe institucionet e tjera relevante.

Sigurisht që të arriturat e Gjykatës përgjatë vitit të kaluar janë fillimisht rezultat i punës së palodhshme të gjyqtarëve të saj, por edhe Këshilltarëve Kushtetues Juridik, administratës dhe të gjithë stafit të Gjykatës, përkushtimi i të cilëve kontribuon në mënyrë të vazhdueshme në jetësimin e plotë të mandatit kushtetues të Gjykatës Kushtetuese në harmoni me standardet më të mira ndërkombëtare. Për më te për, faqet e dedikuara dhe partnerëve të vazhdueshëm të Gjykatës, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në Këshillin e Evropës, Ambasadën Franceze, Ambasadën Amerikane dhe Agjencinë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar, Ambasadën Gjermane dhe IRZ-në Gjermane.

Për vitin vijues, Gjykata mbetet thellësisht e përkushtuar që përmes vendimmarrjes në rastet para saj, por edhe përmes aktiviteteve të cilat në mënyrë të vazhdueshme e avancojnë më tej kualitetin, efikasitetin, llogaridhënien dhe transparencën, të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës, si autoriteti përfundimtar në Republikë për interpretimin e Kushtetutës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe liritë themelore për të gjithë qytetarët e saj.

Gresa Caka-Nimani



Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

RAPORT VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2022

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata apo Gjykata Kushtetuese) është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, si dhe, bazuar në Kushtetutë, është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Në vitin 2022, Gjykata Kushtetuese pranoi 220 kërkesa të reja, nga të cilat Gjykata vendosi për 184 kërkesa. Ndërsa, duke përfshirë edhe lëndët të cilat janë bartur nga vitet e kaluara dhe janë vendosur në vitin 2022, Gjykata publikoi në ueb-faqen e saj dhe ua dorëzoi palëve 170 vendime.


Të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese u publikuan në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me paragrafin 2 të nenit 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe në pajtim me paragrafin 3 (i) të rregullit 16 (Seancat administrative) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës e Gjykatës), Gjykata Kushtetuese miratoi raportin e saj vjetor për vitin 2022 në seancën administrative të mbajtur më 3 maj 2023.

Në pajtim me paragrafin 2 të nenit 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 18 (Sekretariati) të Rregullores së punës së Gjykatës, Sekretariati gjatë vitit 2022 organizoi mbarëvajtjen e shtatë (7) seancave administrative. Në këto seanca administrative u morën tridhjetë e dy (32) vendime.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2022, ishte e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare;
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar;
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare;
Safet Hoxha, gjyqtar;
Radomir Laban, gjyqtar;
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare;
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar;
Enver Peci, gjyqtar (nga 12 dhjetori 2022).



Gresa Caka-Nimani
kryetare




Bajram Ljatifi
zëvendëskryetar




**Selvete Gërxhaliu-
Krasniqi**
gjqtare



Safet Hoxha
gjqtar



Remzije Istrefi-Peci
gjqtare



Radomir Laban
gjqtar



Nexhmi Rexhepi
gjqtar



Enver Peci
gjqtar

SEKRETARIATI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 12 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Gjykatën Kushtetuese) dhe në pajtim me rregullin 18 të Rregullores së punës së Gjykatës, ka kryer punët administrative dhe ka mbështetur punën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Sekretariati udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm i cili, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e Sekretariatit. Struktura organizative e Sekretariatit përbëhet nga:

- Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti i Administratës dhe i Burimeve Njerëzore (DABNJ);
- Departamenti për Regjistrim të Lëndëve, Statistikë dhe Arkiv (DRLSA);
- Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP);
- Departamenti për Buxhet dhe Financa (DBF);
- Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI);
- Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB);
- Njësia e Prokurimit (NJP); dhe
- Njësia e Teknologjisë së Informacionit, e Komunikimit dhe Multimedieve (NJTIKM).

Në realizimin e objektivave të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2021-2025 (në tekstin e mëtejshëm: Plani Strategjik i Gjykatës 2021-2025), nga **103** aktivitete të parapara për zhvillim gjatë vitit 2021, **64** prej tyre janë realizuar me sukses apo **62.14%**.

Funksionimi i Njesisë Ligjore (NJL), e përbërë nga këshilltarët kushtetues-juridikë dhe personeli tjetër ligjor, si dhe struktura dhe organizimi i saj, janë përcaktuar me Rregulloren e Njesisë Ligjore nr. 03/2019 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e Njesisë Ligjore). Këshilltarët kushtetues-juridikë mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve.

Gjatë vitit 2022, Sekretariati i Gjykatës ka realizuar këto objektiva:

- Implementimi i Planit Strategjik të Gjykatës 2021-2025;
- Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2023-2025; dhe
- Hartimi i Regjistrit të Rrezikut për vitin 2022.

Gjatë vitit të kaluar, Sekretariati i Gjykatës gjithashtu publikoi:

- Raportin vjetor të punës për vitin 2021;
- Buletin informativ nr. 14 (janar-qershor 2022);
- Buletin e Praktikës Gjyqësore për vitin 2021;
- Buletin periodik, janar-mars 2022;
- Buletin periodik, prill-qershor 2022; dhe
- Buletin periodik, korrik-shtator 2022.

NJËSIA LIGJORE

NJËSIA LIGJORE

Njësia Ligjore është strukturë e veçantë organizative e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, e themeluar në bazë të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, si dhe Rregullores së Njesisë Ligjore Nr.03/2019. Njësia Ligjore i përgjigjet drejtpërdrejt Kryetarit/es dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Roli parësor i Njesisë Ligjore është që të ofrojë mbështetje profesionale për gjyqtarët e Gjykatës duke bërë hulumtime dhe analiza ligjore dhe duke ndihmuar në hartimin e raporteve paraprake, vendimeve si dhe materialit tjetër ligjor që është i nevojshëm për punën e Gjykatës. Në këtë drejtim, Njësia Ligjore është përgjegjëse që të ndihmojë Gjykatën drejt sigurimit të një cilësie të lartë të vendimmarrjes dhe të konsistencës së praktikës gjyqësore. Për këto qëllime, Njësia Ligjore, mes tjerash, kryen hulumtime shteruese ligjore (i) në nivel të së drejtës kombëtare; (ii) të drejtës kushtetuese rajonale dhe ndërkombëtare; (iii) të drejtës ndërkombëtare dhe asaj krahasuese; (iv) të opinioneve, rekomandimeve dhe praktikave të mira të nxjerra nën ombrellën e Këshillit të Evropës dhe Komisionit të Venecias; (v) praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; dhe, sipas nevojës, edhe të (vi) gjykatave të tjera ndërkombëtare. Po ashtu, Njësia Ligjore (vii) përgatit materiale të ndryshme për diskutim dhe vendosje përgjatë seancave administrative të Gjykatës si dhe seancave profesionale që mbahen me gjyqtarët dhe këshilltarët e Gjykatës.

Funksionet e tjera të rëndësishme të Njesisë Ligjore janë: (i) takimi me palët dhe asistimi i Sekretariatit në pranimin e kërkesave dhe dokumenteve shtesë; (ii) filtrimi i të gjitha kërkesave të reja të dorëzuara në Gjykatë dhe hartimi i një raporti fillestar filtrues në lidhje me kërkesat e dorëzuara nga palët; (iii) identifikimi i kërkesave me masë të përkohshme dhe urgjencave të tjera që një kërkesë mund të paraqet varësisht nga natyra e rastit; (iv) mbajtja dhe përditësimi i bazave të të dhënave siç janë: baza e të dhënave e llojit të kërkesave dhe pretendimeve të ngritura, baza e të dhënave për zbatimin e vendimeve të Gjykatës, dhe po ashtu baza e të dhënave për përcjelljen e gjendjes së secilit rast që nga fillimi e deri në publikimin e tij. Të gjitha vendimet e Gjykatës klasifikohen sipas sistemit të filtrimit nga Njësia Ligjore para publikimit në ueb-faqen e Gjykatës sipas kriterëve të paracaktuara me qëllim të ofrimit të mundësisë për një kërkim më të lehtë shkencor, profesional dhe akademik për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe komunitetin juridik që i qasen vendimeve përmes ueb-faqes së saj.

Njësia Ligjore përbëhet nga: Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik; Juriskonsulti; Zëvendës Këshilltarët e Parë Kushtetues Juridikë; Këshilltarët e Lartë Kushtetues Juridikë; Këshilltarët Kushtetues Juridikë dhe Këshilltari i Lartë për Administrimin e Kërkesave. Aktualisht, Njësia Ligjore përbëhet nga 16 anëtarë dhe udhëhiqet dhe mbikëqyrret nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik i cili ndihmohet nga dy Zëvendës Këshilltarët e Parë Kushtetues Juridikë. Që të tre këta, si dhe Juriskonsulti, zgjidhen nga gjyqtarët e Gjykatës nga radha e këshilltarëve të lartë kushtetues juridikë për një periudhë tri (3) vjeçare. Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik, mes tjerash, ndihmon dhe këshillon Gjykatën në kryerjen e funksioneve të saj; mbështet të gjithë anëtarët e Njesisë Ligjore në kryerjen e detyrave të tyre, mbikëqyr organizimin, aktivitetin dhe performancën e anëtarëve të Njesisë ligjore, si dhe në draftimin e raporteve paraprake dhe kryerjen detyrave të tjera. Ndërsa roli i Juriskonsultit është që të këshillojë Gjykatën dhe ta njoftojë atë për çështje të ndryshme që ndërliken me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe praktikën e re të GjEDNJ-së me synim të sigurimit të konsistencës së praktikës gjyqësore. Në bashkërendim me Këshilltarin e Parë Kushtetues Juridik, Juriskonsulti ndihmon dhe propozon rekomandime përkatëse me qëllim të sigurimit të cilësisë së lartë të vendimmarrjes dhe konsistencës së praktikës gjyqësore të Gjykatës.

Anëtarët e Njesisë Ligjore kanë role specifike të krijuara për nevojat e Gjykatës. Ata kanë statusin e të punësuarit me kohë të pacaktuar dhe kushte specifike të punës dhe përshkrimet e sakta të detyrave të tyre të punës janë të përcaktuara me Ligjin për Gjykatën, Rregulloren e punës dhe Rregulloren për Njësine Ligjore. Sa i përket këshillimeve që ofrojnë, ata janë të pavarur dhe të lirë të shprehin mendimin e tyre profesional në lidhje me çdo kërkesë në të cilën ata punojnë.

Njësia Ligjore mban takime të rregullta lidhur me organizimin e punës së saj, duke përfshirë por pa u kufizuar në: (i) përcjelljen e statusit të rasteve; (ii) diskutimin e çështjeve të ndryshme juridiko-kushtetuese; (iii) propozimin e akteve të brendshme të Gjykatës; si dhe (iv) diskutimin rreth praktikës gjyqësore të vet Gjykatës por edhe të GJEDNJ-së. Faktor i rëndësishëm në sigurimin e vendimmarrjes efikase juridike dhe të ngritjes së cilësisë së hartimit të raporteve dhe të vendimeve, është trajnimi i këshilltarëve profesional të Gjykatës në fushën e të drejtës kushtetuese, ndërkombëtare dhe të të drejtave të njeriut. Në kuadër të aktiviteteve të Gjykatës, anëtarët e Njesisë Ligjore kanë marrë pjesë në punëtori profesionale gjatë tërë vitit. Lista e plotë e aktiviteteve të këshilltarëve juridikë mund të gjendet në Pjesën e këtij raporti - Aktivitetet e Gjykatës.

Përgjatë vitit 2022, Njësia Ligjore ka arritur që të përmbushë të gjitha detyrat e saj drejt ofrimit të mbështetjes së gjyqtarëve në trajtimin e rasteve që janë paraqitur në Gjykatë. Përgjatë këtij viti janë trajtuar një numër i lartë i rasteve në të cilat Njësia Ligjore ka dhënë kontribut të vazhdueshëm në procesin e analizimit të rasteve, përgatitjes së hulumtimeve ligjore dhe hartimit të vendimeve, bazuar në vendimmarrjen e gjyqtarëve të Gjykatës.

Njësia Ligjore vazhdon të jetë e përkushtuar në ngritjen e profesionalizmit të saj, nëpërmjet realizimit të projekteve të ndryshme që ofrohen dhe mundësohen nga partnerët strategjikë të Gjykatës Kushtetuese. Në vazhdimësi dhe përgjatë gjithë vitit, Gjykata Kushtetuese është e hapur për të ofruar takime me studentë dhe grupe të tjera të interesuara, me qëllim që të njoftojë të gjithë të interesuarit lidhur me punën e Gjykatës Kushtetuese, rolin e saj të përcaktuar me Kushtetutë si dhe kërkesat që paraqiten pranë saj.

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE
NJERËZORE**

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE

I. Burimet njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve

Gjatë vitit 2022, DABNJ në zbatim të planit të punës, mbështeti mbarëvajtjen e punës së Sekretarisë në përputhje me mandatin e saj. Gjatë kësaj periudhe, në përputhje me shënimet e personelit, u ndërmorën aktivitetet e përshkruara më poshtë.

Në kuadër të raportimit dhe organizimit të punës janë hartuar dhe dorëzuar:

- Raporti vjetor i të punësuarve për vitin 2021;
- Plani i rekrutimit për vitin 2022;
- Raporti vjetor i DABNJ-së për vitin 2021;
- Raporti vjetor i trajnimeve;
- Raporti vjetor i pushimeve;
- Buxheti gjinor i stafit të Gjykatës;
- Indikatorët e performancës për periudhën janar-maj 2022.

Organizimi i pesë (5) konkurseve të jashtme për plotësimin e gjashtë (6) pozitave:

- Një (1) pozitë: Zyrtar për Protokoll, e cila ka rezultuar pa kandidatë të suksesshëm;
- Një (1) pozitë: Zyrtar për Multimedia edhe ueb faqe, e cila ka rezultuar pa kandidatë të suksesshëm;
- Një (1) pozitë: Përkthyes në DPP, e cila është plotësuar më 1 korrik 2022;
- Një (1) pozitë: Këshilltar i lartë kushtetues juridik, e cila ka rezultuar pa kandidatë të suksesshëm;
- Dy (2) pozita: Këshilltar kushtetues juridik, e cila ka rezultuar me një (1) kandidat të suksesshëm. Zyrtari pritet të fillojë punën në janar të vitit 2023.

Organizimi i dy (2) procedurave të avancimit, përmes konkurseve të brendshme për plotësimin e pozitave: një (1) Drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale dhe një (1) Certifikues, të cilat përfunduan me anulim të konkurseve;

Organizimi i shprehjes së interesit për angazhimin e tetë (8) Praktikantëve, për periudhë një (1) vjeçare. Nga tetë (8) pozitat e lira, shtatë (7) kandidatë u rekomanduan, ndërsa filluan punën praktike vetëm pesë (5) prej tyre.

Gjatë kësaj periudhe është zhvilluar një (1) procedurë e vlerësimit të periudhës provuese, me ç'rast është konfirmuar kalimi me sukses i periudhës provuese.

Sa i përket mbështetjes së procesit të procedurave të rekrutimit dhe avancimit, DABNJ ka ofruar të gjitha shërbimet mbështetëse, përkatësisht menaxhimin e procedurave të rekrutimit, si në vijim: regjistrimin e aplikacioneve, draftimin e Vendimeve për formimin e Komisioneve Përzgjedhëse, përgatitjen e formularëve përkatës, procedimin e ftesave/njoftimeve, organizimin e testeve dhe intervistave, hartimin e raporteve finale, përgatitjen e përgjigjeve në ankesa e deri në komunikim të rezultateve.

Tre (3) zyrtarë të Gjykatës mbushën dhjetë (10) vite pune të pandërprerë në Gjykatën Kushtetuese gjatë vitit 2022 dhe të njëjtit u shpërblyen me pagën jubilarë.

Gjithashtu, janë përgatitur dhe ofruar akt-emërime, kontrata të punës, vendime për përfundim të marrëdhënies së punës, Vendime për grupe punuese, Vendime për themelimin e Komisioneve Përzgjedhëse, Vendime për shpërblym Jubile, Vendime për përdorim të veturave zyrtare, e Vërtetime të dëshmisë së punësimit sipas kërkesave të zyrtarëve. Në baza

të rregullta është evidentuar vijueshmëria e stafit si dhe është bërë përditësimi i evidencës së pushimeve vjetore dhe mjekësore.

Në kuadër të zbatimit të kërkesave nga seancat administrative dhe planit të veprimit të Planit Strategjik, janë zhvilluar këto aktivitete:

- inicimi dhe zhvillimi i procedurës lidhur me shprehjen e interesit për kërkesën për sigurim privat shëndetësor të stafit. Pas komunikimit dhe konsultimit të ofertave të pranuar është përzgjedhur oferta më e favorshme nga kompania e sigurimeve “Elsig”;
- janë formuar nëntë (9) grupe punuese në kuadër të ndryshimeve në rregullativën e brendshme dhe aktiviteteve të parapara me Planin e Veprimit të Planit Strategjik;
- janë nxjerrë tri (3) rregullore të brendshme dhe dy (2) udhëzime administrative;
- është iniciuar procedura për krijimin e softuerit elektronik për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe depos.

Gjatë këtij viti, për sa i përket pushimeve të veçanta një (1) zyrtare e Gjykatës ka shfrytëzuar pushimin pa pagesë, kurse pesë (5) zyrtare kanë shfrytëzuar pushimin prindëror me 70% të pagës, ndërsa dy (2) zyrtare të emëruara në funksione publike vazhdojnë të ushtrojnë të drejtën për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës.

Sa i përket zbatimit të Planit Strategjik, janë mbajtur dy Punëtori lidhur me zbatimin e planit të veprimit të planit strategjik 2022 si dhe Regjistrin e Rrezikut.

Në fund të kësaj periudhe ka filluar procesi i vlerësimeve vjetore të rezultateve të punës për gjithë stafin e Gjykatës.

Gjithashtu, është bërë përditësimi i evidencës së pushimeve vjetore për të gjithë stafin si dhe janë përcjellë njoftimet për shfrytëzimin e pushimit vjetor të mbetur, dhe mundësinë e bartjes së 12 ditëve në vitin vijues, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, në kuadër të ndryshimeve në listën e pagave dhe të dhënave statistikore përgjatë vitit 2022, janë:

- Tre (3) punonjës të ri;
- Pesë (5) pushime prindërore;
- Një (1) pushim pa pagesë;
- Gjashtë (6) pozita të larguara nga lista e pagave dhe transferimi në kategorinë “Subvencione” të dy (2) ish kryetarëve dhe katër (4) zyrtarëve të angazhuar në përputhje me Ligjin për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë.

Për sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore, përgjatë vitit kanë ndodhur:

- Tre (3) dorëheqje;
- Një (1) pensionim;
- Një (1) përfundim i marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit;
- Një (1) pezullim i dakorduar.

Nga numri i përgjithshëm prej shtatëdhjetë (70) punëtorësh të lejuar me buxhetin e vitit 2022, në fund të kësaj periudhe, numri i përgjithshëm i të punësuarve në listën e pagave të muajit dhjetor 2022 është gjashtëdhjetë (60) të punësuar, prej të cilëve:

Numri i të punësuarve sipas gjinisë:

- 29 apo 48.33%, janë të gjinisë mashkullore;
- 31 apo 51.67%, janë të gjinisë femërore.

Numri i të punësuarve sipas përkatësisë nacionale:

- 54 apo 90%, janë shqiptarë;
- 3 apo 5%, janë serbë;
- 2 apo 3.33%, janë boshnjakë; dhe
- 1 apo 1.67% malazias.

Figura nr. 1: Numri i të punësuarve sipas përkatësisë nacionale:





Figura nr.2: Numri i të punësuarve sipas gjinisë:



II. Ngritja e kapaciteteve (trajnimet dhe zhvillimi i karrierës)

Gjatë vitit 2022, DABNJ hartoi planin e ngritjes së kapaciteteve për stafin kushtetues administrativ, bazuar në identifikimin e nevojave të zyrtarëve nga planet individuale të trajnimeve, si dhe në vazhdimësi janë përditësuar dhe evidentuar të gjitha aktivitetet e stafit përgjatë këtij viti. Gjithsej u realizuan 58 aktivitete, si në vijim:

- dy (2) vizita zyrtare;
- gjashtë (6) konferenca ndërkombëtare;
- shtatë (7) shkëmbime përvojash jashtë vendit;
- pesëmbëdhjetë (15) punëtori brenda vendit;
- dy (2) punëtori jashtë vendit;
- dy (2) shkolla verore;
- tri (3) forume rajonale/kongrese ndërkombëtare;
- gjashtë (6) seminare jashtë vendit;
- një (1) seancë profesionale dhe informuese;
- njëmbëdhjetë (11) trajnime profesionale brenda vendit;
- një (1) takim konsultativ jashtë vendit;
- dy (2) kurse të gjuhëve të huaja.

Në vijim paraqesim të dhënat e aktiviteteve të realizuara sipas kronologjisë:

1. Më 21 janar 2022 është mbajtur një Punëtori përkitazi me rolin dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, si dhe raportin e saj me gjykatat e rregullta dhe institucionet e tjera në vend. Në këtë punëtori morën pjesë gjyqtarë të sapoemëruar nga gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës, ligjërues nga gjyqtari Nexhmi Rexhepi;
2. Më 22-23 shkurt 2022, përmes platformës online, është mbajtur trajnimi me temën “Menaxhimi dhe zhvillimi i Burimeve Njerëzore”, i organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike, me një (1) pjesëmarrës;
3. Më 22 shkurt 2022, përmes platformës online, është mbajtur Punëtorja me temën “Kontrolli Incidental”, i organizuar nga IRZ në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese, në të cilin kanë marrë pjesë njëzet e tre (23) pjesëmarrës;
4. Më 7 mars 2022, ka filluar kursi i gjuhës frënge, të cilin e ka mundësuar Ambasada e Francës në bashkëpunim me Aleancën Franceze në Prishtinë. Kursi mbahet në gjykatë me gjithsej nëntë (9) pjesëmarrës;
5. Më 22-23 mars 2022, në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, është mbajtur trajnimi me temën “Përgatitja dhe Menaxhimi i Projekteve”, i organizuar nga IKAP, me gjashtë (6) pjesëmarrës;
6. Më 24-25 mars 2022, në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, është mbajtur trajnimi me temën “Microsoft Visio & Microsoft Publisher”, i organizuar nga IKAP, me një (1) pjesëmarrës;
7. Më 29-30 mars 2022, në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, është mbajtur trajnimi me temën “Komunikimi efektiv”, i organizuar nga IKAP, me pesë (5) pjesëmarrës;
8. Më 1 prill 2022, në Budva, është mbajtur “Forumi i parë i Barazisë Gjinore për Ballkanin Perëndimor”, i organizuar nga qendra AIRE dhe Mbretëria e Bashkuar, me një (1) pjesëmarrës nga gjykata;

9. Më 12 prill 2022, në Prishtinë, është mbajtur Konferenca lansuese e projektit “Mbështetje për Gjykatën Kushtetuese në aplikimin dhe përhapjen e standardeve evropiane të të drejtave të njeriut”, e mbështetur nga Këshilli i Evropës, në të cilën morën pjesë njëzet e pesë (25) pjesëtarë të gjykatës;
10. Më 18 prill-18 qershor 2022, me mbështetje të Këshillit të Evropës, një (1) gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese, qëndroi në Gjykatën e Strasburgut për 2 muaj të plotë, me qëllim të përvetësimit sa më të mirë të praktikave të gjyqësisë evropiane dhe zbatimin e tyre në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës;
11. Më 26 prill 2022, me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Turqisë, është zhvilluar një vizitë zyrtare në Ankara, në të cilën kanë marrë pjesë dy (2) pjesëtarë të gjykatës;
12. Më 27-28 prill 2022, në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, është mbajtur trajnimi me temën “Menaxhimi i Performancës Institucionale”, i organizuar nga IKAP, me dy (2) pjesëmarrës nga gjykata;
13. Më 27-29 prill 2022, në Durrës është mbajtur punëtorja me temën “Propozimet për Ndryshimin e Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese”, e organizuar nga Gjykata Kushtetuese, me gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) pjesëmarrës;
14. Më 28-29 prill 2022, në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, është mbajtur trajnimi me temën “Microsoft Excel”, i organizuar nga IKAP, me një (1) pjesëmarrës nga gjykata;
15. Më 29 prill 2022, në Institutin KAF, kanë filluar trajnimin me temën “Auditor i IT i certifikuar AITC”, në të cilën marrin pjesë dy (2) zyrtarë nga gjykata;
16. Më 5 maj 2022, në Shkup është mbajtur “5th Itinerant Summer University in the Balkans: Crisis of the Rule of Law in Balkans and EU”. Ky aktivitet është organizuar nga Universiteti i Shkupit “Cyril and Methodius”, me një (1) pjesëmarrës nga gjykata;
17. Më 15 maj-16 korrik 2022, me mbështetje të Këshillit të Evropës, një (1) gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ka qëndruar në Gjykatën e Strasburgut për 2 muaj të plotë, me qëllim të përvetësimit sa më të mirë të praktikave të gjyqësisë evropiane dhe zbatimin e tyre në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës;
18. Më 17-18 maj 2022, me mbështetje të IRZ-së, në Prishtinë është mbajtur Konferenca me temën “Ndërveprimi i juridiksionit gjyqësor dhe kushtetues për garantimin e shtetit të së drejtës: përvoja nga Kosova, Shqipëria dhe Gjermania”, me gjithsej njëzet e një (21) pjesëmarrës nga gjykata;
19. Më 25 maj 2022, në gjykatë është mbajtur “Punëtorja lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit të Planit Strategjik 2021-2025 për vitin 2022”, me pesëmbëdhjetë (15) pjesëmarrës;
20. Më 2-3 qershor 2022, në Shkup është mbajtur Konferenca “Harmonisation of judicial practice: length of proceedings – standards and case law”, e organizuar nga Gjykata Supreme e Maqedonisë së Veriut, me mbështetje të Unionit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Në këtë aktivitet ishin prezentë tre (3) pjesëmarrës nga gjykata;
21. Më 6 qershor 2022, në Prishtinë, është mbajtur punëtorja për gjyqtarët dhe këshilltarët e Gjykatës Kushtetuese mbi temën “Electoral Disputes and European Convention on


Human Rights”. Ky aktivitet ishte mbështetur nga Këshilli i Evropës, dhe në të morën pjesë njëzet (20) pjesëtarë të gjykatës;

22. Më 19 qershor-19 gusht 2022, me mbështetje të Këshillit të Evropës, një (1) këshilltare e Gjykatës Kushtetuese, ka qëndruar në Gjykatën e Strasburgut për 2 muaj të plotë, me qëllim të përvetësimit sa më të mirë të praktikave të gjyqësisë evropiane dhe zbatimin e tyre në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës;
23. Më 29 qershor 2022, në gjykatë është mbajtur “Seanca Profesionale e Gjykatës Kushtetuese”, në të cilën morën pjesë katërmëdhjetë (14) pjesëtarë të gjykatës;
24. Më 6-7 dhe 13-14 korrik 2022, në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, është mbajtur trajnimi me temën “Analiza Statistikore dhe Interpretimi (SPSS)”, i organizuar nga IKAP, me një (1) pjesëmarrës nga gjykata;
25. Më 20 korrik 2022, në Gjykatë, është mbajtur Punëtorja Orientuese për stafin e posa punësuar në Gjykatën Kushtetuese, e organizuar nga Gjykata Kushtetuese, me gjithsej nëntë (9) pjesëmarrës;
26. Më 21-24 korrik 2022, në Tiranë është mbajtur një Takim Konsultativ mbi “Kodin e Etikës”, i organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe SIDA. Në këtë takim morën pjesë shtatë (7) pjesëmarrës. Pjesëmarrësit ishin të shoqëruar nga 2 vozitës të gjykatës;
27. Më 27-29 korrik 2022, në Bogë, është mbajtur Punëtorja mbi “Rregulloren e Punës të Gjykatës Kushtetuese”, e organizuar nga Gjykata Kushtetuese, me gjithsej njëzet e katër (24) pjesëmarrës;
28. Më 31 gusht-3 shtator 2022, në Irlandë është mbajtur “Konferenca lidhur me aplikimin efektiv të Konventës në shtetet e kontestuara Evropiane”. Kjo konferencë ishte organizuar nga Presidenca e Irlandës në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, me gjithsej tre (3) pjesëtarë të gjykatës;
29. Më 11 shtator-12 nëntor 2022, me mbështetje të Këshillit të Evropës, një (1) këshilltare e Gjykatës Kushtetuese, ka qëndruar në Gjykatën e Strasburgut për 2 muaj të plotë me qëllim të përvetësimit sa më të mirë të praktikave të gjyqësisë evropiane dhe zbatimin e tyre në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës;
30. Më 15-16 shtator 2022, në Riga të Letonisë, është mbajtur konferenca ndërkombëtare me temën: “Sustainability as a Constitutional Value: Future Challenges”, me dy (2) pjesëmarrës nga gjykata;
31. Më 15-16 shtator 2022, në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, është mbajtur trajnimi me temën “Mediet Sociale dhe Komunikimi Digjital”, i organizuar nga IKAP, me një (1) pjesëmarrës nga gjykata;
32. Më 18 shtator-12 nëntor 2022, me mbështetje të Këshillit të Evropës, një (1) këshilltare e Gjykatës Kushtetuese, ka qëndruar në Gjykatën e Strasburgut për 2 muaj të plotë me qëllim të përvetësimit sa më të mirë të praktikave të gjyqësisë evropiane dhe zbatimin e tyre në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës;
33. Më 20-24 shtator 2022, me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, dy (2) pjesëmarrës nga gjykata kanë marrë pjesë në Shkollën Verore, me temën: “Interpretation of the Constitution in the Protection of Fundamental Rights and Freedoms” e cila është realizuar në Ankara.

34. Më 21-24 shtator 2022, në Tallin të Estonisë është mbajtur Seminari me temën: “Applying EU Anti-discrimination Law”, i organizuar nga ERA, me dy (2) pjesëmarrës nga Gjykata;
35. Më 22-24 shtator 2022, në Romë të Italisë, është mbajtur seminari me temën “Notre Dame Judicial Seminar on Constitutionalism and the Rule of Law”, i organizuar nga Universiteti i Notre Damit, me dy (2) pjesëmarrës nga gjykata;
36. Më 25-29 shtator 2022, në Strasburg të Francës është mbajtur seminari me temën “Human Rights and Access to Justice”, i organizuar nga EJTN, me dy (2) pjesëmarrës nga gjykata;
37. Më 26 shtator 2022, ka filluar kursi i gjuhës serbe, aktivitet ky i organizuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), me mbështetje të Ambasadës Britanike në Prishtinë. Në kurs marrin pjesë gjithsej shtatë (7) pjesëmarrës;
38. Më 4-7 tetor 2022, në Bali të Indonezisë u mbajt kongresi i 5-të i Konferencës Botërore të Drejtësisë Kushtetuese, me gjithsej katër (4) pjesëmarrës;
39. Më 19-22 tetor 2022, në Tiranë, është shënuar 30 vjetori i themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe konferenca ndërkombëtare me temën “Roli i Gjykatave Kushtetuese në demokracitë e reja”, me gjithsej pesëmbëdhjetë (15) pjesëmarrës;
40. Më 21-22 tetor 2022, në Zagreb të Kroacisë është mbajtur seminari me temën “Liria e shprehjes”, i organizuar nga EJTN, me gjithsej dy (2) pjesëmarrës;
41. Më 24-25 tetor 2022, në Prishtinë, është mbajtur Punëtorja mbi “Ndryshimet e Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese”, e organizuar me mbështetjen e USAID, me gjithsej tridhjetë (30) pjesëmarrës;
42. Më 7 nëntor 2022, në ambientet e Gjykatës është mbajtur punëtorja orientuese për Praktikantët e angazhuar, me gjithsej trembëdhjetë (13) pjesëmarrës;
43. Më 10 nëntor 2022, në Prishtinë, është mbajtur trajnimi me temën “Planifikimi strategjik, treguesit e performancës” organizuar nga IKAP, me një (1) pjesëmarrës;
44. Më 10 nëntor 2022, në Prishtinë, është mbajtur trajnimi me temën “Menaxhimi i kontratës përmes e-prokurimit” organizuar nga IKAP, me një (1) pjesëmarrës;
45. Më 21-22 nëntor 2022, në Prishtinë, me mbështetje të Këshillit të Evropës është mbajtur punëtorja me temën “Procedimi efektiv i rasteve të dhunës kundër grave dhe rasteve të dhunës në familje – standardet dhe praktika evropiane” me gjithsej tetëmbëdhjetë (18) pjesëmarrës;
46. Më 23-25 nëntor 2022, në Shqipëri, është mbajtur punëtorja e dytë e Planit të Veprimit të Planit Strategjik, dhe Regjistrin e Rrezikut për vitin 2022, organizuar nga Gjykata, me gjithsej dymbëdhjetë (12) pjesëmarrës;
47. Më 25-29 nëntor 2022, në Shqipëri, u organizua seminari me temën “Kontrolli i brendshëm, menaxhimi i rrezikut dhe krijimi i regjistrit të rrezikut” organizuar nga Instituti IKAF, me gjithsej dy (2) pjesëmarrës;
48. Më 25-29 nëntor 2022, në Shqipëri, u organizua seminari me temën “Menaxhimi i Buxhetit dhe Kontabiliteti Publik SNKSP-IPSAS” organizuar nga Instituti IKAF, me gjithsej një (1) pjesëmarrës;

49. Më 25-26 nëntor 2022, në Tiranë, u mbajt forumi i nëntë rajonal i Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore, me temën “Të drejtat e njeriut në kohë emergjencash – roli i gjyqësorit sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” me tre (3) pjesëmarrës nga gjykata;
50. Më 29 nëntor-3 dhjetor 2022, u realizua vizita zyrtare në Paris të Francës, realizuar me mbështetjen e Ambasadës së Francës në Kosovë, me gjithsej dy (2) pjesëmarrës;
51. Më 5-16 dhjetor 2022, në ambientet e Gjykatës, u realizua programi i trajnimit në fushën e komunikimit të brendshëm përmes pesë (5) punëtorive me temat “(i) Ekipet e mira dhe kultura organizative, (ii) Komunikimi dhe konflikti, (iii) Ndërtimi i ekipeve dhe i besimit, (iv) Ndryshimi dhe komunikimi, (v) dhe takimet e shkëlqyera” nga ekspertja amerikane e angazhuar në kuadër të programit Fulbright, me gjithsej njëzet e shtatë (27) pjesëmarrës;
52. Më 12-22 dhjetor 2022, në Tiranë, u realizua programi i shkëmbimit me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit, ku dy (2) pjesëmarrës nga gjykata u vendosën në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë;
53. Më 13-14 dhjetor 2022, në Prishtinë, me mbështetjen e Këshillit të Evropës, nëpërmjet Projektit të Përbashkët të BE/Këshillit të Evropës, Projekti kundër krimit Ekonomik (PECK III), u organizua trajnimi me temën “Mbrotjtja e sinjalizuesve: mekanizmat dhe procedurat”, me një (1) pjesëmarrës;
54. Më 20-21 dhjetor 2022, në Prishtinë, me mbështetje të Këshillit të Evropës është mbajtur punëtorja me temën “Mjetet efektive juridike”, me gjithsej njëmbëdhjetë (11) pjesëmarrës.

Figura nr. 3: Pjesëmarrja e stafit të Gjykatës Kushtetuese në vizita studimore, konferenca dhe shkolla verore jashtë vendit, konferenca/punëtori brenda dhe jashtë vendit, trajnime brenda dhe jashtë vendit, kurse të gjuhëve të huaja:



III. Mbështetja administrative dhe logjistike

DABNJ ka siguruar ofrimin e shërbimeve administrative dhe të shërbimeve tjera që ndihmojnë në kryerjen dhe shtimin e efikasitetit në punë për gjithë stafin e Gjykatës:

- Është organizuar dhe është bërë pranimi dhe shpërndarja e inventarit për të punësuarit e ri dhe janë furnizuar të gjithë të punësuarit në Gjykatë me pajisje të nevojshme të IT-së;
- Është bërë regjistrimi, mirëmbajtja dhe servisimi i rregullt i veturave të Gjykatës dhe përpilimi i raporteve të veçanta për shpenzimet e derivateve;
- Është kryer kontrolli i hyrje-daljeve të materialit shpenzues dhe pajisjeve të IT-së, si dhe është bërë regjistrimi i tij në Sistemin e Menaxhimit të Informatave të E-pasurisë;
- Pas furnizimit me material shpenzues dhe të pajisjeve të IT-së, si dhe shërbimeve për nevoja pune të Gjykatës, është bërë regjistrimi i 194 faturave në Sistemin “Free Balance”;
- Janë përpiluar raporte të veçanta lidhur me ngarkimin apo shkarkimin me pajisje pune për të punësuarit e Gjykatës;
- Janë përpiluar një seri shkresash drejtuar institucioneve të ndryshme lidhur me ekzekutimin e kërkesave të ndryshme administrative dhe ofrimin e shërbimeve për nevoja të Gjykatës.

IV. Biblioteka e Gjykatës (Shërbimet e bibliotekës)

Nga fusha e bibliotekës janë kryer këto aktivitete, përkatësisht është pranuar dhe regjistruar kjo literaturë:

- Ka vazhduar anëtarësimi vjetor i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës (ABEK), përmes së cilit ofrohet qasja në këto burime elektronike: “Cambridge Journals Online, Edward Elgar Publishing, IMF- International Monetary Fund, Open Edition Journals, ASTM- Compass”;
- Ka vazhduar abonimi vjetor i Gjykatës Kushtetuese në burimet elektronike të Gazetës Universitare të Oksfordit, përmes së cilave ofrohet qasja në këto burime elektronike: “Max Planck Encyclopedia of International Law, ORIL - International Human Rights Law, ORIL - International Law in European Courts, Oxford Constitutions of the World”;
- Është vazhduar memorandumi i bashkëpunimit vjetor i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës (ABEK), përmes së cilit ofrohet qasja në këto burime elektronike: “Cambridge Journals Online, Edward Elgar Publishing, IMF- International Monetary Fund, Open Edition Journals, ASTM- Compass”;

Janë pranuar dhe regjistruar në sistemin elektronik, titujt në vijim:

- “ICL Journal: Vienna Journal on International Constitutional Law, volume 15 issue 4”;
- Përmbledhje e Raporteve Vjetore drejtuar autoriteteve përgjegjëse gjatë vitit 2021, nga Institucioni i Avokatit të Popullit;
- “Selected Judgments of the Italian Constitutional Court 2020”, nga Gjykata Kushtetuese e Italisë;
- “Italian Constitutional Court Annual Report 2021”, nga Gjykata Kushtetuese e Italisë;
- “Constitutional Court of Austria: Activity Report 2021”, nga Gjykata Kushtetuese e Austrisë;

- “Verfassungsgerichtshof: Tätigkeitsbericht 2021”, nga Gjykata Kushtetuese e Austrisë;
- “Constitutional Studies, volume II”, (libri është dygjuhësor: anglisht dhe bullgarisht), botim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Bullgarisë;
- “ICL Journal: Vienna Journal on International Constitutional Law, 2022, volume 16, issue”, nga ICL Journal.

**DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE,
STATISTIKËS DHE ARKIVIT**

DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT

I. Statusi i lëndëve

Gjatë vitit 2022, Gjykata ka pasur në punë gjithsej 365 kërkesa/lëndë, nga të cilat 220 janë pranuar dhe 145 janë bartur nga vitet e kaluara:

- 1 kërkesë e vitit 2019 është zgjidhur;
- 9 kërkesa të bartura nga viti 2020 janë zgjidhur;
- 134 kërkesa janë bartur nga viti 2021, prej të cilave 111 janë zgjidhur, ndërsa në proces janë 23 kërkesa;
- 220 kërkesa janë pranuar në vitin 2022, prej të cilave 62 janë zgjidhur dhe në proces janë 158 kërkesa.


Në këtë periudhë, 184 kërkesa janë zgjidhur ose 50.41% e kërkesave që gjykata ka pasur në punë gjatë vitit 2022.

Gjatë kësaj periudhe, 170 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës dhe janë përcjellë tek palët, ndërsa 13 të tjera të zgjidhura janë në proces të përgatitjes.

Gjatë periudhës në fjalë, mesatarisht janë pranuar 18,3 kërkesa në muaj, ndërsa janë zgjidhur 15,3.

Dinamika mujore e kërkesave të pranuar dhe të zgjidhura është si në vijim:

Grafikoni nr. 1 : Dinamika e kërkesave sipas muajve (1 janar – 31 dhjetor 2022)



II. Struktura e parashtruesve të kërkesave


Juridiksioni dhe palët e autorizuar për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese është i përcaktuar me Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Departamenti për regjistrimin e lëndëve, statistikë dhe arkiv gjatë vitit 2022 ka pranuar 220 kërkesa të reja.

Struktura e kërkesave të parashtruara është:

- 185 kërkesa kanë qenë individuale (nga personat fizikë), ose 84,1%;
- 28 kërkesa nga organizata punuese (nga personat juridikë), ose 12,7%; dhe
- 7 kërkesa nga autoritetet publike (nga institucionet), ose 3,2%.

Grafikoni nr. 2: Struktura e parashtruesve të kërkesave



III. Shpërndarja e kërkesave

Në përputhje me Nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, DRLSA i ka proceduar të gjitha kërkesat e parashtruara sipas Nenit 113 të Kushtetutës.

Shpërndarja e kërkesave/lëndëve për Gjyqtarët raportues është bërë në përputhje me rregullin 10 dhe 36 të Rregullores së punës të Gjykatës. Përjashtim nga ky rregull është shpërndarja e kërkesave për vënien e Masës së përkohshme, të cilat kërkesa procedohen sipas rregullit 57 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, dhe rasteve *ad hoc*, të cilat paraqesin konflikt interesi, në përputhje me Nenin 18 të Ligjit për Gjykatat dhe në pajtim me rregullin 9 të Rregullores së punës.


IV. Qasja në Gjykatë dhe besimi i publikut në punën e Gjykatës

Të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht përkatësisë etnike, fetare apo gjinore, kanë qasje të barabartë në Gjykatën Kushtetuese.

Qasja etnike e individëve tregohet si në vijim:

- 167 kërkesa nga shqiptarët, ose 90,3 %;
- 16 kërkesa nga komuniteti serb, ose 8,6 %; dhe
- 2 kërkesa nga nacionalitetet të tjera, ose 1,1 %.


Grafikoni nr. 3: Struktura etnike e parashtruesve të kërkesave (1 janar – 31 dhjetor 2022)



V. Struktura gjinore e parashtruesve të kërkesave tregohet si vijon:

- 24 kërkesa të parashtruara nga gjinia femërore, ose 13,0%;
- 150 kërkesa të parashtruara nga gjinia mashkullore , ose 81,1%; dhe
- 11 kërkesa të parashtruara në grup, ose 5,9%.

Grafikoni nr. 4: Struktura gjinore e parashtruesve të kërkesave (1 janar– 31 dhjetor 2022)




VI. Tipologjia e shkeljeve të supozuara

Tipologjia e shkeljeve të supozuara nga 120 kërkesat e pranuar gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2021, është si në vijim:

- Neni 46 [Mbrojtja e Pronës], 6.3%
- Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 3.8%
- Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 31.9%
- Neni 24 [Barazia para Ligjit], 9.9%
- Neni 21 [Parimet e Përgjithshme], 0.6%
- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 2.5%
- Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut], 0.6%
- Neni 25 [E Drejta për Jetën], 0.4%
- Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 2.1%
- Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 1.9%
- Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 7.0%
- Neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 0.6%
- Neni 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër], 0.6%
- Neni 36 [E Drejta e Privatësisë], 0.4%
- Neni 37 [E Drejta e Martesës dhe Familjes], 0.4%
- Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 0.6%
- Neni 50 [Të Drejtat e Fëmijës], 0.2%
- Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 4.0%
- Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 10.6%
- Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], 1.1%
- Neni 3 [Barazia para Ligjit], 2.3%
- Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 0.4%
- Neni 7 [Vlerat], 1.3%
- Neni 13 [Kryeqyteti], 0.6%
- Neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], 0.4%
- Neni 101 [Shërbimi Civil], 0.4%
- Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], 3.4%
- Neni 109 [Prokurori i Shtetit], 0.8%
- Neni 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës], 0.4%
- Shkelje të tjera, 4.8%


Grafikoni nr. 5: Tipologjia e shkeljeve të supozuara të neneve të Kushtetutës (1 janar – 31 dhjetor 2022)



VII. Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 208 kërkesa ose 94,5 % e tyre kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave; dhe
- 12 kërkesa ose 5,5 % e kërkesave kanë të bëjnë me Autoritetet tjera publike.

Grafikoni nr. 6: Shkelësit e supozuar të të drejtave (1 janar – 31 dhjetor 2022)




VIII. Afati i zgjidhjes së kërkesave

Gjatë vitit 2022, Gjykata Kushtetuese ka publikuar 170 vendime.

Grafikoni në vijim, pasqyron dinamikën e afatit të zgjidhjes dhe publikimit të kërkesave sipas muajve dhe ditëve, i cili varion prej 5.06 muajve në 10.14 muaj ose shprehur në ditë nga 158 ditë në 319 ditë.

Grafikoni nr. 7: Afati i zgjidhjes së kërkesave (1 janar – 31 dhjetor 2022)



Seancat dhe kolegjet shqyrtuese


Gjatë vitit 2022, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 38 seanca plenare, me 209 kolegje shqyrtuese.

Rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime për papranueshmëri, aktvendime për mospërmbarim, vendime për masë të përkohshme, vendime për ndërprerje të shqyrtimit të kërkesës dhe vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër.

Struktura e 170 vendimeve të publikuar gjatë periudhës në fjalë është si në vijim:

- 20 Aktgjykime;
- 134 Aktvendime për papranueshmëri;
- 11 Refuzime të kërkesës me procedurë të shkurtër;
- 2 Vendime për tërheqje të kërkesës;
- 1 Aktvendime për mospërmbarim;
- 2 Urdhra të tjerë.

Grafikoni nr. 8: Struktura e vendimeve të publikuara (1 janar – 31 dhjetor 2022)



Në vitin 2022, Gjykata Kushtetuese ka publikuar 20 aktgjykime:

- Aktgjykim në rastin KI113/21, Parashtrues: Bukurije Haxhimurati, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.nr.29/2021, të 13 prillit 2021;
- Aktgjykim në rastin KO93/21, Parashtrues: Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 08-R-01, të 6 majit 2021;
- Aktgjykim në rastin KI75/21, Parashtrues: “Abrazen LLC”, “Energy Development Group Kosova LLC”, “Alsi & Co.Kosovë LLC” dhe “Building Construction LLC” Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ-UZVP. nr.44/2020 të Gjykatës Supreme, të 23 korrikut 2020;
- Aktgjykim në rastin KI49/20, Parashtrues: Shehide Muhadri, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 530/2016 të 10 dhjetorit 2019;
- Aktgjykim në rastin KI182/20, Parashtrues: Sedat Kovaçi, Servet Ergin, Ilirjana Kovaçi dhe Sabrije Zhubi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. 54/2020 të 6 korrikut 2020;
- Aktgjykim në rastin KI156/20, Parashtrues: Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Ac. Nr. 5514/18 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 13 majit 2019; dhe Aktvendimit Cml. Nr. 8/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 17 qershorit 2020;
- Aktgjykim në rastin KI44/21, Parashtrues: Besa Sopi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-I-20-0019 të 21 janarit 2021;

- *Aktgjykim në rastin KO145/21, Parashtrues: Komuna e Kamenicës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/24, të 23 prillit 2021;*
- *Aktgjykim në rastin KI78/21, Parashtrues: Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., Vlerësim i kushtetutshmërisë së pikës së dytë të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 257/2019, të 2 qershorit 2020;*
- *Aktgjykim në rastin KI133/20, Parashtrues: Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., Vlerësim i kushtetutshmërisë së pikës së dytë të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 12/2020, të 19 shkurtit 2020;*
- *Aktgjykim në rastin KI55/21, Parashtrues: Muhamet Ademi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 387/2020, të 13 janarit 2021;*
- *Aktgjykim në rastin KI196/21, Parashtrues: Gëzim Shtufi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit PML. nr. 310/2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 14 shtatorit 2021;*
- *Aktgjykim në rastin KI10/22, Parashtrues: Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ.nr. 115/2021, të 18 nëntorit 2021;*
- *Aktgjykim në rastin KI19/21, Parashtrues: Sadik Pllana, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr. 239/2019, të 26 nëntorit 2020;*
- *Aktgjykim në rastin KI116/21, Parashtrues: Sali Rexhepi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 104/20, të 25 shkurtit 2021;*
- *Aktgjykim në rastin KI230/21, Parashtrues: Global Trade-af, SH.P.K, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP-nr. 45/2021, të 28 prillit 2021;*
- *Aktgjykim në rastin KO173/21, Parashtrues: Komuna e Kamencës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 3, 4, 5, 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) nr. 104/2020 për “Kriteret dhe Procedurat e Themelimit dhe Pushimit të Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit Parauniversitar”;*
- *Aktgjykim në rastin KO27/21, Parashtrues: Gjykata Supreme e Republikës Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 94 (Mbikëqyrja) të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës;*
- *Aktgjykim në rastin KI159/20, Parashtrues: ADOL sh.p.k., Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr. 29/19, të 1 korrikut 2020;*
- *Aktgjykim në rastin KI202/21, Parashtrues: “Kelkos Energy” sh.p.k., Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ.UZVP.Nr.74/21], i 28 korrikut 2021.*

DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE

DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE

Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP) është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të përkthimit, të redaktimit, të lekturës dhe të harmonizimit të terminologjisë në të gjitha dokumentet e Gjykatës Kushtetuese në gjuhët në të cilat punon Gjykata.

DPP-ja ka organizuar, ka udhëhequr dhe ka mbikëqyrur punën e përkthimit (në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze edhe për ueb-faqen zyrtare të Gjykatës), të redaktimit e të lekturës dhe të përkthimit aty për aty (në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe dhe në gjuhën angleze). Kështu që, nëpër DPP kanë kaluar 29111,9 faqe të shkresave, të dokumenteve të ndryshme, të aktgjykimeve, të aktvendimeve, të vendimeve për heqje nga lista, të raporteve paraprake e të tjera në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe, në gjuhën angleze dhe në gjuhën turke.

Përkthyesit kanë bërë 745:30 orë përkthime të atypëratyshme në takime të rregullta, në seanca shqyrtuese dhe administrative, punëtori dhe konferenca të ndryshme, si dhe në intervista të kandidatëve për pozitat e shpallura nga Gjykata.

Në bashkërenditje me DRLSA-në, DPP-ja ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për takimet e gjyqtarëve dhe për seancat shqyrtuese e administrative.

DPP-ja ka bërë procedimin e lëndëve në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe dhe në gjuhën angleze. Njëkohësisht, ka kontribuar në publikimin e vendimeve në shqip, në serbisht, në anglisht dhe në frëngjisht.

DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCIVE

DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCIVE

Duke u mbështetur në Ligjin Nr.08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës, buxheti i aprovuar për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës për vitin 2022 ka qenë **2,081,273.00€**.

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
1,388,837.00€	487,356.00€	4,000.00€	110,000.00€	91,080.00€	2,081,273.00€

Në tremujorin e tretë të vitit fiskal 2022, përbërja e buxhetit ka pësuar ndryshime ku në bazë të shkresës SP-1401/22/mv të 26 korrikut 2022, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) nga kategoria e Investimeve kapitale - projekti “Automjete me kod 11136” transferin/rialokimin në shumë prej 16,400.00€ (gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind euro), në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu, nga kategoria e Subvencioneve dhe transfereve janë transferuar/rialokuar 13,500.00€ (trembëdhjetë mijë e pesëqind euro) në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve.

Andaj buxheti me ndryshime për tremujorin e tretë ishte si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzimet e komunaleve	Investimet kapitale	Subvencionet & transferet	TOTAL
1,388,837.00	517,256.00	4,000.00	93,600.00	77,580.00	2,081,273.00

Në katër mujorin e fundit, respektivisht më 18 tetor 2022, Gjykata Kushtetuese pranoi nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve shkresën me Nr.ref/2335, me titull “Përmbyllja e vitit fiskal”, përmes së cilës kërkoi nga organizatat buxhetore të dhënat për kursimet e mundshme sipas kategorive të shpenzimeve. Në përgjigje të kësaj kërkesë, më 20 tetor 2022 përmes shkresës me Nr.ref.: SP-1964/22/mv, Gjykata planifikoi kursimin e mjeteve financiare në kategorinë e Shpenzimeve kapitale me kod të projektit 11136 – Automjete, ku me qëllim të rregullimit të brendshëm të buxhetit kërkoi kursimin e shumës 48,600.00€ (dyzetetë mijë e gjashtëqind euro) në mënyrë që të transferoheshin në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve, për mbulimin e obligimeve të cilat Gjykata i kishte në shërbimet e përkthimit për vitin fiskal 2022, dhe për arsye të mos bartjes së këtyre obligimeve në buxhetin e vitit fiskal 2023. Si rrjedhojë më datë 27 dhjetor 2022 Qeveria e Republikës së Kosovës nëpërmjet Vendimit me Nr.14/115, aprovoi kërkesën e MFPT për ndryshimet dhe kursimet e buxhetit, ku është e përfshirë edhe kërkesa e Gjykatës Kushtetuese.

Buxheti përfundimtar i Gjykatës pas ndryshimeve në SIMFK për vitin 2022 paraqitet si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
1,388,837.00€	565,856.00€	4,000.00€	45,000.00€	77,580.00€	2,081,273.00€

	Buxheti i aprovuar 2022 (A) €	Alokimet janar-shtator (B) €	Realizimet janar-shtator (C) €	% (C/A) €	% (C/B) €
Paga dhe mëditje	1,388,837.00	1,209,699.43	1,209,699.43	87.10	100
Mallra dhe shërbime	565,856.00	565,856.00	541,634.04	95.72	95.72
Shpenzime komunale	4,000.00	4,000.00	2,749.72	68.74	68.74
Subvencione dhe transfere	77,580.00	77,580.00	71,546.24	92.22	92.22
Investime kapitale	45,000.00	45,000.00	0.00	0.00	0.00
Donacionet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	2,081,273.00	1,902,135.43	1,825,629.43	87.72	95.98

Alokimet e mjeteve nga buxheti i Kosovës sipas rrjedhjes së parasë për periudhën janar – dhjetor

Në buxhetin e përgjithshëm, pjesëmarrja e alokimit në vitin 2022 ka qenë 1,902,138.43 € e shprehur në përqindje 91.39%.

	Janar-Shtator €	Tetor €	Nëntor €	Dhjetor €	Gjithsej €	%
Paga dhe mëditje	914,206.79	98,005.33	98,487.99	98,999.32	1,209,699.43	87.10
Mallra dhe shërbime	429,900.00	40,000.00	40,000.00	55,956.00	565,856.00	100
Shpenzime komunale	3,100.00	300.00	300.00	300.00	4,000.00	100
Subvencione dhe transfere	68,310.00	7,590.00	1,680.00	0.00	77,580.00	100
Investime kapitale	93,600.00	0.00	(48,600.00)	0.00	45,000.00	100
Donacionet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	1,509,116.79	145,895.33	91,867.99	155,255.32	1,902,138.43	91.39

Realizimi i buxhetit për periudhën janar – dhjetor

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit në vitin 2022 ka qenë 1,902,138.43 €, e shprehur në përqindje 95.98%.

Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim¹:

Paga dhe mëditje	Alokimet janar – dhjetor (A) €	Realizimi janar – dhjetor (B) €	Mbetja e mjeteve (C) €	% (B/A) €
Paga dhe mëditje	1,209,699.43	1,209,699.43	0.00	100
Mallra dhe shërbime	565,856.00	541,634.04	24,221.96	95.72
Shpenzime komunale	4,000.00	2,749.72	1,250.28	68.74
Subvencione dhe transfere	77,580.00	71,546.24	6,033.76	92.22

¹ Në realizimin e buxhetit nuk është përfshirë avansi për para të gatshme në shumë prej 1,000.00 €, pasi që nuk konsiderohet si shpenzim, realizim deri te rimbushja ose barazimi i avansit.

Investime kapitale	45,000.00	0.00	45,000.00	0.00
Donacionet	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	1,902,135.43	1,825,629.43	76,506.00	95.98

Realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje

Realizimi i pagave dhe mëditjeve sipas muajve:

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti	Realizimi	Mbetja
Janar	69	111,400.30	111,400.30	0.00
Shkurt	63	103,699.91	103,699.91	0.00
Mars	63	103,989.96	103,989.96	0.00
Prill	60	98,059.66	98,059.66	0.00
Maj	60	99,457.11	99,457.11	0.00
Qershor	60	99,250.72	99,250.72	0.00
Korrik	61	99,657.41	99,657.41	0.00
Gusht	61	100,293.69	100,293.69	0.00
Shtator	60	98,398.03	98,398.03	0.00
Tetor	60	98,005.33	98,005.33	0.00
Nëntor	60	98,487.99	98,487.99	0.00
Dhjetor	60	98,999.32	98,999.32	0.00
Gjithsej		1,209,699.43	1,209,699.43	0.00

Realizimi i buxhetit për mallra dhe shërbime

Realizimi i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2022 të ndara sipas muajve:

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	50,000.00	50,000.00	49,492.39	507.61
Shkurt	60,000.00	60,000.00	54,779.69	5,220.31
Mars	40,000.00	40,000.00	34,467.54	5,532.46
Prill	40,000.00	40,000.00	45,043.11	(5,043.11)
Maj	40,000.00	40,000.00	25,992.54	14,007.46
Qershor	50,000.00	50,000.00	64,759.88	(14,759.88)
Korrik	35,000.00	35,000.00	32,743.61	2,256.39
Gusht	64,900.00	64,900.00	57,803.83	7,096.17
Shtator	50,000.00	50,000.00	53,951.75	(3,951.75)
Tetor	40,000.00	40,000.00	35,233.23	4,766.77
Nëntor	40,000.00	40,000.00	27,395.24	12,604.76
Dhjetor	55,956.00	55,956.00	59,971.23	(4,015.23)
Gjithsej	565,856.00	565,856.00	541,634.04	24,221.96

Buxheti i ndarë për investime kapitale sipas kodeve të projekteve

Projektet	Kodet e projekteve	Buxheti i aprovuar €	Realizimi €	Mbetja €
Paisje IT	11132	30,000.00	0.00	30,000.00
Softver	11135	15,000.00	0.00	15,000.00
Atomjete	11136	(48,600.00)	0.00	0.00
Gjithsej:		45,000.00	0.00	45,000.00

Realizimi i buxhetit për shpenzime komunale

Realizimi i buxhetit në kategorinë e shpenzimeve komunale për vitin 2022 të ndara sipas muajve:²

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	350.00	350.00	0.00	350.00
Shkurt	350.00	350.00	210.22	139.78
Mars	350.00	350.00	430.48	(-80.48)
Prill	350.00	350.00	220.03	129.97
Maj	350.00	350.00	210.22	139.78
Qershor	350.00	350.00	224.18	125.82
Korrik	350.00	350.00	257.93	92.07
Gusht	350.00	350.00	226.18	123.82
Shtator	300.00	300.00	241.33	58.67
Tetor	300.00	300.00	260.47	39.53
Nëntor	300.00	300.00	238.07	61.93
Dhjetor	300.00	300.00	230.61	69.39
Gjithsej	4,000.00	4,000.00	2,749.72	1,250.28

Realizimi i buxhetit për Subvencione dhe Transfere

Buxheti për subvencione dhe transfere për vitin 2022 është 77,580.00€. Alokimi i mjeteve për subvencione dhe transfere për nëntë mujorin e parë është 68,310.00€, që përbën 88.05% të buxhetit për subvencione dhe transfere për vitin fiskal 2022. Nga kjo kategori ekonomike, nga muaji shkurt 2022 janë realizuar pagat e ish zyrtarëve të lartë (ish Kryetarët me stafin e tyre mbështetës), ndërsa nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë realizuar pagesat për tatime në paga si dhe kontributet e pensioneve, sipas nenit 9 të ligjit Nr. 03/L-001 dhe 04/L-038.

Realizimi i buxhetit në kategorinë e Subvencioneve dhe transfereve për vitin 2022, i ndarë sipas muajve:

² Shpenzimet komunale nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës janë bërë vetëm në kodin e telefonisë fikse, shpenzimet e rrymës, mbeturinave i mbulon Ministria e Administratës Publike.

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	7,590.00	7,590.00	0.00	7,590.00
Shkurt	7,590.00	7,590.00	5,978.72	1,611.28
Mars	7,590.00	7,590.00	5,978.72	1,611.28
Prill	7,590.00	7,590.00	6,808.74	781.26
Maj	7,590.00	7,590.00	0.00	7,590.00
Qershor	7,590.00	7,590.00	12,947.50	(5,357.50)
Korrik	7,590.00	7,590.00	6,638.76	951.24
Gusht	7,590.00	7,590.00	6,638.76	951.24
Shtator	7,590.00	7,590.00	6,638.76	951.24
Tetor	7,590.00	7,590.00	6,638.76	951.24
Nëntor	1,680.00	1,680.00	6,638.76	(-4,958.76)
Dhjetor	0.00	0.00	6,638.76	(-6,638.76)
Gjithsej	77,580.00	77,580.00	71,546.24	6,033.76

Ish zyrtarët e lartë me stafin e tyre mbështetës në muajin janar 2022 kanë qenë të përfshirë në listën e pagave në kodin për paga dhe mëditje, por pas plotësimit të kushteve të alokimit të buxhetit dhe në koordinimin me Thesarin, nga muaji shkurt 2022 këto pagesa kanë filluar të ekzekutohen nga dy kategori ekonomike: Subvencionet dhe Transferet për pagat e ish zyrtarëve të lartë (ish Kryetarët me stafin e tyre) dhe nga kategoria Mallra dhe Shërbime pagesat për tatime në paga dhe kontribute të pensioneve, sipas nenit 9 të ligjit Nr. 03/L-001 dhe 04/L-038.

NJËSIA E PROKURIMIT

NJËSIA E PROKURIMIT

Në mbështetje të planit të prokurimit për vitin 2022, Njësia e Prokurimit ka iniciuar dhe zhvilluar gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) aktivitete të prokurimit dhe janë nënshkruar gjashtëmbëdhjetë (16) kontrata.

Bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, aktivitetet e prokurimit i kemi klasifikuar sipas tipit, vlerës dhe procedurës, të paraqitura në detaje si në vijim:

a. Procedurë me vlerë minimale (deri 1000 euro)

b. Procedurë e kuotimit të çmimeve (vlerë e vogël)

c. Procedurë e hapur (vlerë e mesme)

d. Procedurë e hapur (vlerë e madhe)

a) Procedurë me vlerë minimale

Gjatë vitit 2022 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsej pesë (5) aktivitete me vlerë minimale dhe janë nënshkruar pesë (5) kontrata.

1. Furnizim me pajisje të imta për TI;
2. Furnizim me goma vere;
3. Punimi i reklamës ndriçuese me logon e Gjykatës;
4. Ndërrimi dhe montimi i gomave, balancimi dhe hotelimi (ruajtja) e gomave;
5. Furnizim me pelerina (mantele) për gjyqtarët e Gjykatës.

b) Procedurë e kuotimit të çmimeve (vlerë e vogël)

Gjatë vitit 2022 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsej një (1) aktivitet i kuotimit të çmimeve dhe është nënshkruar një (1) kontratë.

1. Furnizim me material shpenzues zyrtar.

c) Procedurë e hapur (vlerë e mesme)

Gjatë vitit 2022 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsej nëntë (9) aktivitete, përkatësisht një (1) procedurë e hapur, një (1) procedurë e bartur në vitin 2023, e ndarë në tri lote, si dhe janë nënshkruar dhjetë (10) kontrata, si në vijim:

1. Shërbime me pije jo alkoolike dhe pije të nxehta për stafin zyrtar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
2. Marrje në shfrytëzim të pajisjeve me sensor për spërkatje të duarve me dezinfektues dhe shërbimet e dezinfektimit gjeneral të objektit;
3. Sigurimi i veturave zyrtare TPL, TPL Plus dhe Full Kasko–EU;
4. Lot 1 “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve VW, Audi dhe Skoda”, Lot 2 “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Toyota RAV4” dhe Lot 3 “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Mitsubishi Lancer 1.5 benzinë”;
5. Zhvillimi i sistemit për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe logjistikës;
6. Shpallje e konkurseve dhe publikimeve tjera në portale (gazeta ditore);
7. Shërbime të larjes së veturave zyrtare;
8. Shërbime të mbjelljes dhe furnizimit me lule të gjalla; dhe
9. Furnizim me automjet zyrtar.

d) Procedurë e hapur (vlerë e madhe)

Gjatë vitit 2022 është iniciuar dhe zhvilluar gjithsej një (1) aktivitet i prokurimit i ndarë në dy lote, i cili është bartur në vitin 2023, si në vijim:

1. Lot I – Shërbime të përkthimit me shkrim, lektura dhe harmonizimi i teksteve nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, në gjuhën serbe, në gjuhë të tjera sipas nevojës dhe anasjelltas;
2. Lot II – Përkthimi i atypëratyshëm (simultan) i seancave dhe takimeve zyrtare.

Pasqyrimi në tabelë i të gjitha pagesave të realizuara gjatë vitit 2022 i furnizimeve, shërbimeve dhe punëve tjera sipas kontratave të nënshkruara:

Pagesat e furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për kontratat e nënshkruara në vitin 2022	Shuma e përgjithshme e pagesave gjatë vitit 2022
Shuma e kontratave, duke përfshirë të gjitha taksat	286,023.08 €
Shuma e paguar për kontrata	37552.1 €
Shuma e përgjithshme	323,575.18 €

NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE MULTIMEDIAVE

NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, KOMUNIKIMIT DHE MULTIMEDIAVE

Njësia e Teknologjisë së Informacionit, Komunikimit dhe Multitmediave është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve dhe përkujdesjen profesionale në infrastrukturën e përgjithshme të teknologjisë informative në Gjykatën Kushtetuese.

Gjatë kësaj periudhe, njësia e TIK dhe Multimedia ka realizuar projekte të rëndësishme, duke krijuar sisteme të qëndrueshme dhe profesionale, pajisje të avancuara dhe të sigurta me qëllim të ofrimit të shërbimeve dhe arritjes së objektivave në përputhje me planin e punës dhe planin strategjik të Gjykatës Kushtetuese.

Projektet e realizuara

- Avancimi i projektit të sistemit CDMS, projekt ky i financuar nga Këshilli i Evropës. Në këtë projekt janë integruar të gjitha ndryshimet e kërkuara që kanë për qëllim automatizimin dhe avancimin e procesit të ecurisë dhe menaxhimit të lëndëve që regjistrohen në Gjykatë nëpërmjet sistemit elektronik CDMS;
- Konfigurimi dhe aprovimi i politikave të brendshme të sigurisë dhe aplikimi për të gjithë përdoruesit në domenin e Gjykatës, duke u bazuar në ngritjen e sigurisë për shkak të situatës së sulmeve kibernetike që ishin drejtuar kundër institucioneve të Kosovës;
- Zhvillimi i ueb-faqes në gjuhën frënge. Është realizuar përkthimi në gjuhën frënge i të gjithë ueb-faqes zyrtare të Gjykatës, si dhe intervenimi dhe avancimet në ueb-faqen e vendimeve, krijimi i vegëzave (linkave) brenda vendimit, zhvillimi i tabelave statistikore dhe përmirësimet tjera sipas kërkesave nga përdoruesit;
- Avancimi dhe konfigurimi i DVR (Hapësirës për incizimin e kamerave të sigurisë), rritja e kapacitetit dhe zgjatja e afatit për ruajtjen e incizimeve për çështje të sigurisë;
- Blerja e pajisjeve të TIK-ut. Është iniciuar dhe përfunduar proceduara për blerjen e pajisjeve të Teknologjisë Informative dhe përmes kësaj procedure janë blerë gjithsej 10 copë PC-Allinone dhe 5 copë Laptop;
- Inicimi i projektit për zhvillimin e sistemit për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe logjistikës. Ky projekt vazhdon të jetë ende në proceduara të prokurimit dhe të vlerësimit, i cili projekt ka kaluar që të zhvillohet në vitin 2023;
- Planifikimi dhe dorëzimi i projekteve që do të financohen me donacion nga Këshilli i Evropës. Në kuadër të bashkëpunimit me Këshillin e Evropës, kemi propozuar dhe prezantuar 6 projekte konkrete për infrastrukturën e teknologjisë informative në Gjykatë, që kanë të bëjnë me përmirësimin e kapaciteteve të përgjithshme të shërbimeve të teknologjisë informative dhe avancimin e sistemeve elektronike për menaxhimin e rasteve. Për këtë projekt ishin të angazhuar edhe dy ekspertë nga Këshilli i Evropës të cilët kanë mbajtur takime me të gjitha departamentet për të evidentuar kërkesat që lidhen me këto projekte. Të gjitha projektet e propozuara janë aprovuar nga Këshilli i Evropës me buxhet prej 80.000 euro;
- Administrimi teknik i 44 seancave shqyrtuese, seanca administrative, trajnimeve dhe takimeve të ndryshme;

- Dizajnimi dhe konfigurimi në formatin mbrojtës .pdf, i formularëve të ri të kërkesës (KI) dhe (KO) së bashku me udhëzuesin për përdorim, të cilët janë aprovuar dhe publikuar në ueb-faqen e Gjykatës;
- Dizajnimi dhe publikimi i Buletinit periodik të praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese për periudhat tremujore. Gjithsej janë publikuar 3 buletine periodike.

Aktivitetet e realizuara

- Administrimi dhe mirëmbajtja e serverëve dhe infrastrukturës teknologjike, duke vazhduar angazhimin e plotë nën përkujdesjen e stafit profesional të Njesisë së TIK-ut. Gjatë kësaj periudhe janë administruar dhe mirëmbajtur të gjithë serverët në gjendje funksionale, duke u kujdesur në mënyrë periodike për monitorimin e gjendjes fizike, menaxhimin dhe kontrollin e sigurisë, kontrollimin e llogave, monitorimin e temperaturës në dhomën e serverëve dhe furnizimin me rrymë dhe UPS për infrastrukturën teknologjike dhe të pajisjeve përcjellëse. Gjatë kësaj periudhe janë zëvendësuar disa pjesë të dëmtuara në dhomën e serverëve dhe këto intervenime dhe konfigurime janë kryer me sukses, duke kthyer sistemin në funksion të plotë. Për të gjithë serverët fizikë dhe ata virtualë janë krijuar dhe administruar kopjet rezervë për qëllime të sigurisë;
- Intervenimi dhe kontrollimi i rrjetës brenda Gjykatës dhe përditësimi i versioneve të reja (update) të sistemeve operative dhe pakove të Office për të gjitha pajisjet duke i aprovuar dhe instaluar me kujdes nga Administratori i Sistemit;
- Krijimi i kopjeve (back-up) të rregullta për bazën e të dhënave të CDMS-it, përkujdesja dhe eliminimi i gabimeve, si dhe sigurimi në ruajtjen e të dhënave në dy kopjet e serverëve;
- Përkujdesja dhe ofrimi i shërbimeve për mbarëvajtjen e sistemeve operative dhe pajisjeve të teknologjisë dhe komunikimit për të gjithë të punësuarit në Gjykatë. Është intervenuar edhe përmes distancës në ofrimin e shërbimeve të TI-së për mbajtjen e seancave online;
- Menaxhimi dhe organizimi i detyrave teknike brenda Njesisë duke ofruar përkrahjen e nevojshme për funksionalizimin sa më të mirë të pajisjeve të Teknologjisë Informative dhe sistemeve brenda Gjykatës;
- Konfigurimi dhe instalimi i konzollës së Antivirusit në serverët e Gjykatës dhe aplikimi i përditësimeve të reja të Microsoft-it për të gjithë kompjuterët;
- Pjesëmarrja në komisionet me grupet punuese për ndryshimet dhe përditësimet e akteve të brendshme ligjore;
- Gjatë vitit 2022, janë kërkuar të iniciohen gjithsej 5 procese të prokurimit për blerjen e pajisjeve të ndryshme të TI-së, mirëmbajtje, softuerë dhe pjesë përcjellëse sipas planit të paraparë për këtë vit;
- Montimi, instalimi dhe konfigurimi i kompjuterëve të ri për Gjyqtarët dhe regjistrimi në domenin e Gjykatës, transferimi i të dhënave, duke i mirëmbajtur pajisjet e brendshme në ngritjen e sistemeve operative në Windows 10 dhe softuerët tjerë aplikativ;
- Gjatë vitit 2022, janë publikuar 170 vendime në ueb-faqe në gjuhët përkatëse që janë dërguar dhe është bërë kategorizimi i tyre në bazë të listës së filtrimit.

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Bazuar në planin vjetor për vitin 2022, NJAB ka planifikuar gjithsej katër (4) auditime, prej të cilave tri auditime kanë rezultuar me raport final. Gjatë vitit 2022 janë bërë tri (3) detyra shitesë të auditimit. Auditimet me kërkesë janë përfunduar por si pasojë e kësaj auditimi i TM4 për vitin 2022 ka mbetur të përfundohet në pjesën e parë të TM1 të vitit 2023.

Raportet e finalizuara nga NJAB janë:

1. “Funksionimi i Kontrollit të Brendshëm në NJP”;
2. “Funksionimi i kontrollit të brendshëm në NJL”;
3. “Menaxhimi i pasurisë” në kuadër të DBF-së;
4. “Menaxhimi i automjeteve”;
5. “Menaxhimi i shpenzimeve”; dhe
6. “Menaxhimi i kontratave” – ende i papërfunduar.

Gjithashtu, NJAB ka hartuar dhe ka dorëzuar brenda afatit të caktuar:

- **Planin Strategjik të AB për periudhën 2023-2025; dhe**
- **Planin Vjetor të AB për vitin 2023.**

Të gjitha auditimet e brendshme janë zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me qëllim të realizimit të objektivave të institucionit dhe të NJAB-së, që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe me përmirësimin e efikasitetit në punë, me shmangien e gabimeve të mundshme, si dhe me raportimin e parregullsive dhe gabimeve me qëllim të shtimit të kontrollit që të sigurohet funksionimi efikas në departamentet përkatëse.

Në vazhdimësi janë bërë vizita përcjellëse për efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të funksionimit të kontrollit të brendshëm, si dhe të zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i Brendshëm dhe nga Auditori i Përgjithshëm.

Gjykata ka implementuar rekomandimet e dhëna nga auditori i brendshëm dhe nga Auditori i Përgjithshëm, gjë e cila ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së aktiviteteve dhe performancës së institucionit.

1. Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur këshillëdhënës në Gjykatë funksionon bazuar në:

- Udhëzimin Administrativ për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektet e Sektorit Publik;
- Statutin e KAB-së;
- Praktikat e mira; dhe
- Standardet ndërkombëtare të auditimit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2022 ka mbajtur pesë (5) takime dhe ka siguruar mbikëqyrje të planeve, raporteve dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna nga auditorët.

ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM

ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM

Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI) në fushën e përgjegjësi të saj përfshin: informimin dhe komunikimin me mediat/publikun, monitorimin e mediave, publikimin e njoftimeve në ueb-faqen e Gjykatës përkitazi me vizitat/aktivitetet dhe seancat/vendimet, publikimin e Buletinit Informativ të Gjykatës, publikimin e Librit të Gjykatës dhe të fletushkave/broshurave të tjera informative, komunikimin me palët/qytetarët, protokollin, kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe bashkëpunimin me Komisionin e Venecias.

Gjatë vitit 2022, në Zyrën për Komunikim dhe Informim (ZKI) janë kryer këto aktivitete:

I. Monitorimi i mediave:

- Janë përpiluar 125 raporte ditore të mediave
- Janë përpiluar 48 raporte javore të mediave
- Është bërë arkivimi fizik dhe elektronik i raporteve të mediave të shtypura (48 artikuj) dhe të mediave elektronike (368 artikuj) përkitazi me punën e Gjykatës

II. Komunikimi me mediat/publikun:

- Janë dërguar përgjigjet në 99 pyetje të parashtruara nga mediat e shkruara dhe ato elektronike, si dhe në 335 pyetje/kërkesa të parashtruara nga qytetarët dhe institucionet
- Janë publikuar 38 njoftime përkitazi me vizitat dhe aktivitetet e Gjykatës
- Janë publikuar 21 njoftime me informata përmbledhëse përkitazi me vendimet e Gjykatës
- Janë publikuar 12 njoftime me informata statistikore përkitazi me seancat dhe vendimet e publikuara të Gjykatës

III. Publikimi i fletushkave/broshurave dhe i materialeve të tjera informative:

- Është publikuar Raporti vjetor i mediave për vitin 2022
- Është publikuar numri i 13-të dhe i 14-të i Buletinit Informativ të Gjykatës
- Është publikuar Buletini i Praktikës Gjyqësore për vitin 2021
- Janë publikuar 4 Buletin tremujor të Praktikës Gjyqësore
- Është realizuar produksioni i video-animacionit: *“Si i merr vendimet Gjykata Kushtetuese”*

IV. Aktivitetet protokollare:

- Janë kryer detyrat protokollare përkitazi me 44 vizita zyrtare në Gjykatë, 18 vizita zyrtare jashtë vendit, 19 punëtori/konferenca të organizuara në vend, 4 punëtori/konferenca të organizuara jashtë vendit dhe 5 punëtori/konferenca të organizuara nëpërmjet video-konferencës
- Janë përgatitur 64 letër-këmbime me udhëheqës institucionalë vendorë e ndërkombëtarë

V. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare:

- Gjatë vitit 2022 janë pranuar gjithsej 20 kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës. Një kërkesë nuk është aprovuar dhe dy kërkesa janë lejuar pjesërisht.
- Janë përgatitur 4 raporte tremujore përkitazi me kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës
- Është dorëzuar në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, Raporti vjetor për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës gjatë vitit 2022

VI. Komunikimi me palët/qytetarët:

Gjatë vitit 2022, në recepsionin e Gjykatës janë proceduar:

- 740 qytetarë
- 406 përfaqësues institucionesh

VII. Bashkëpunimi me Komisionin e Venecias:

- Janë dërguar përgjigjet e Gjykatës në 90 pyetje të parashtruara nëpërmjet Forumit të Komisionit të Venecias nga 15 gjykata kushtetuese dhe supreme të shteteve anëtare *(me gjithsej 25 kërkesa)*
- Janë dorëzuar 3 raporte katër-mujore, së bashku me vendimet më të rëndësishme të Gjykatës për publikim në Buletinet e Komisionit të Venecias

AKTIVITETET TJERA TË GJYKATËS KUSHTETUESE

AKTIVITETET TJERA TË GJYKATËS KUSHTETUESE

I. Udhëtimet zyrtare

1 - 2 prill 2022

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë dyditore në Budvë të Malit të Zi, më 1 dhe 2 prill 2022, me ftesën për të marrë pjesë në Forumin e parë të Barazisë Gjimore për Ballkanin Perëndimor.

Organizuar nga Qendra AIRE për Ballkanin Perëndimor dhe me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, Forumi mundësoi shkëmbimin e diskutimeve profesionale ndërmjet kryetarëve dhe gjyqtarëve të gjykatave kushtetuese dhe supreme të vendeve të rajonit dhe atyre evropiane, mbi parimet kryesore që rrjedhin nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) përkritazi me barazinë gjimore.

Gjatë qëndrimit në Budvë, kryetarja Caka – Nimani gjithashtu zhvilloi takime të ndara me kryetarin dhe me zëvendëskryetaren e GJEDNJ – së, z. Robert Spano dhe znj. Siofra O’Leary, si dhe me gjyqtarë dhe ish-gjyqtarë të kësaj gjykate evropiane.

26 - 28 prill 2022

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës i përbërë nga kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka-Nimani dhe zëvendëskryetari i Gjykatës, z. Bajram Ljatifi, realizuan një vizitë zyrtare në Ankara me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Turqisë.

Kryetarja Caka-Nimani dhe zëvendëskryetari Ljatifi qëndruan në kryeqytetin turk me ftesën për të marrë pjesë në ceremoninë e kremtimit të përvjetorit të 60-të të themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, si dhe në Simpoziumin ndërkombëtar dyditor të organizuar me këtë rast, në temën: *“Interpretimi i Kushtetutës në Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore”*.

Gjatë qëndrimit në Ankara, kryetarja Caka-Nimani dhe zëvendëskryetari Ljatifi zhvilluan takime të ndara me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, z. Zühtü Arslan dhe me zëvendëskryetarin e kësaj gjykate, z. Kadir Özkaya, ku temë e diskutimit të përbashkët ishin marrëdhëniet ndërmjet dy gjykatave kushtetuese, si dhe mundësitë për thellimin e mëtejme të bashkëpunimit reciprok.

22 korrik 2022

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në krye me kryetaren e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndruan për vizitë pune në Tiranë më 22 korrik 2022, me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Delegacioni i gjyqtarëve nga Kosova u ftua për të marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në Tiranë dhe me mbështetje të Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), që për qëllim kishte hartimin e Kodit të Etikës të kësaj gjykate.

Punëtorja i filloi punimet me fjalët hyrëse të kryetareve të gjykatave kushtetuese të Shqipërisë dhe Kosovës, znj. Vitore Tusha dhe znj. Gresa Caka – Nimani, ndërsa gjyqtari Nexhmi Rexhepi

prezantoi këndvështrimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës përkitazi me kodin e etikës së gjyqtarëve.

2 shtator 2022

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Remzie Istrefi – Peci, qëndruan për vizitë pune në Galway të Irlandës, më 1 shtator 2022, me ftesën për të marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare me temë: *“Zbatimi efektiv i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në zonat evropiane në konflikt”*.

Në konferencën e organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Irlandës, në bashkëpunim me Qendrën Irlandeze për të Drejtat e Njeriut, njëra nga panelistët pjesëmarrës ishte edhe kryetarja Caka – Nimani, e cila mbajti një prezantim në temën: *“Zbatimi efektiv i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Perspektiva e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës”*.

Gjatë qëndrimit në Galway, kryetarja Caka – Nimani dhe gjyqtarja Istrefi – Peci zhvilluan takime të ndara me akademikë dhe juristë të shquar ndërkombëtarë në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe me gjyqtarë të gjykatave kushtetuese evropiane.

4 - 7 shtator 2022

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, realizuan një vizitë zyrtare në Bali të Indonezisë, me ftesën për të marrë pjesë në Kongresin e 5-të të Konferencës Botërore të Drejtësisë Kushtetuese (WCCJ), më 4 - 7 tetor 2022.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës udhëtoi për në Bali me ftesë të Komisionit të Venecias dhe të Gjykatës Kushtetuese të Indonezisë, si mikpritëse dhe bashkë-organizatore e Kongresit të 5-të të Konferencës Botërore të Drejtësisë Kushtetuese (WCCJ), që këtë vit u organizua në temën: *“Drejtësia kushtetuese dhe paqja”*.

Burimet e së drejtës, përgjegjësitë dhe kufizimet e rolit të gjykatave kushtetuese në ruajtjen e paqes, parimet themelore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe shqyrtimi i pavarësisë së gjykatave kushtetuese, ishin vetëm disa prej temave mbi të cilat shkëmbyen pikëpamjet e tyre profesionale kryetarët dhe gjyqtarët e gjykatave kushtetuese dhe supreme nga 90 shtete anëmbanë botës.

Gjatë qëndrimit në Bali, kryetarja Caka – Nimani u takua me kryetarin “emeritus” të Komisionit të Venecias, z. Gianni Buquicchio, me Sekretarin e përgjithshëm të Konferencës Botërore të Drejtësisë Kushtetuese (WCCJ), z. Rudolph Dürr Schnutz, me Kryetar të disa Gjykatave Kushtetuese dhe Supreme anëtare të WCCJ-së, si dhe me përfaqësues të Asociacionit Frankofon të Gjykatave Kushtetuese dhe të Konferencës Evropiane të Gjykatave Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese e Kosovës është bërë anëtare me të drejta të plota e Konferencës Botërore të Drejtësisë Kushtetuese (WCCJ), që nga më 17 shtator 2014.

16 shtator 2022

Gjyqtaret e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Selvete Gërxxhaliu – Krasniqi dhe znj. Remzie Istrefi – Peci, qëndruan për vizitë pune dyditore në Riga të Letonisë, më 15 dhe 16 shtator 2022.

Ato u ftuan nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Letonisë për të marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë: *“Qëndrueshmëria si një vlerë kushtetuese: Sfidat e së ardhmes”*, organizuar në shënim të 30-vjetorit të themelimit të kësaj gjykate dhe 100-vjetorit të miratimit të Kushtetutës së Letonisë.

Gjatë qëndrimit në Riga, gjyqtaret Gërxhaliu – Krasniqi dhe Istrefi – Peci zhvilluan takim të përbashkët me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Letonisë, z. Aldis Laviņš, si dhe me homologë të tjerë nga gjykatat kushtetuese evropiane pjesëmarrës në konferencë.

20 - 21 shtator 2022

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, udhëtuan për vizitë zyrtare në Tiranë, me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, më 20 - 21 tetor 2022.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u ftua për të marrë pjesë në ceremoninë e shënimit të 30-vjetorit të themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë dhe në Konferencën ndërkombëtare të organizuar me këtë rast, në temën: *“Roli i Gjykatave Kushtetuese në demokracitë e reja”*.

Kryetarja Caka – Nimani, në cilësinë e njëres nga folëset kryesore në Konferencën ndërkombëtare, me pjesëmarrës kryetarë dhe gjyqtarë të gjykatave kushtetuese dhe supreme rajonale dhe evropiane, mbajti një prezantim në temën e jurisprudencës kushtetuese, si garanci për konsolidimin e shtetit të së drejtës.

Gjatë qëndrimit në Tiranë, kryetarja Caka – Nimani dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u pritën në takim të përbashkët nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, znj. Vitore Tusha dhe gjyqtarët e tjerë të kësaj Gjykate.

22 - 24 shtator 2022

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë pune në kryeqytetin italian Romë, më 22-24 shtator 2022.

Ajo u ftua për të marrë pjesë në seminarin gjyqësor me temë: *“Kushtetutshmëria dhe Sundimi i Ligjit”*, organizuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit Notre Dame në Romë, në bashkëpunim me Institutin Kellog për Studime Ndërkombëtare me seli në SHBA.

Gjykimi kushtetues, metodat e interpretimit kushtetues, të drejtat themelore dhe kompetencat e pushtetit ekzekutiv në rrethana të jashtëzakonshme, ishin vetëm disa prej temave të trajtuara në diskutimin e përbashkët të zhvilluar ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave kushtetuese evropiane dhe gjyqtarëve nga Gjykata Supreme e SHBA, si dhe akademikëve e ekspertëve ndërkombëtar në lëmin e drejtësisë.

Gjatë qëndrimit në Romë, kryetarja Caka – Nimani u takua me gjyqtarin e Gjykatës Supreme të SHBA, z. Brett Kavanaugh, si dhe me gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese të Italisë, z. Nicolo Zanon.

21 - 23 shtator 2022

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Turqisë, z. Altin Nika dhe z. Admir Guguli morën pjesë në programin e “Shkolla e 10-të Verore” mbi temën “Interpretation of the Constitution in the Protection of Fundamental Rights and Freedoms”, mbajtur më 21 - 23 shtator 2022, në Ankara.

22 - 23 shtator 2022

Z. Sevdail Kastrati dhe z. Boban Petkovic morën pjesë në Konferencën “Applying EU Anti-Discrimination Law”, organizuar nga Academy of European Law, mbajtur më 22 - 23 shtator 2022, në Tallin, Estonia.

26 - 28 shtator 2022

Z. Bardh Bokshi dhe znj. Resmije Loshi, morën pjesë në Konferencën “Human Rights and Access to Justice”, organizuar nga European Judicial Training Network, mbajtur më 26 - 28 shtator 2022, në Strasbourg, Francë.

18 shtator - 18 nëntor 2022

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës në Prishtinë “*Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese*”, u vendosën dy Këshilltaret, znj. Arbana Beqiri dhe znj. Saranda Çunaku, në GJEDNJ për vizitë studimore dy mujore.

20 - 21 tetor 2022

Z. Veton Dula dhe z. Nexhat Kelmendi morën pjesë në Konferencën “Freedom of Speech in the Digital Era”, organizuar nga European Judicial Training Network, mbajtur më 20 - 21 tetor 2022, në Zagreb, Kroaci.

23 - 25 nëntor 2022

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka mbajtur punëtorinë e Planit të Veprimit 2022 dhe Regjistri i Rrezikut 2022 të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese, më 23 - 25 nëntor 2022, në Durrës, Shqipëri.

25 - 26 nëntor 2022

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, znj. Selvete Gërxhaliu - Krasniqi dhe z. Nexhmi Rexhepi morën pjesë në Forumin e Nëntë Rajonal të Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore me temë: “*Të Drejtat e Njeriut në Kohë Emergjencash – Roli i Gjyqësorit sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut*”, me ftesë nga Qendra AIRE dhe Mbrojtësit e të Drejtave Civile, mbajtur më 25 dhe 26 nëntor 2022, në Tiranë, Shqipëri.

30 nëntor - 2 dhjetor 2022

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare disaditëshe në Paris, më 30 nëntor – 2 dhjetor 2022, që u realizua me mbështetjen e Ambasadës së Francës në Republikën e Kosovës.

Kryetarja Caka-Nimani u takua me kryetarin e Këshillit Kushtetues të Francës, z. Laurent Fabius, dhe me kryetarin e Këshillit Shtetëror të Francës, z. Didier – Roland Tabuteau. Temë e diskutimeve të përbashkëta, në të dy takimet, ishin të arriturat e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit, respektimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në nivel vendi. Në takimet e ndara me z. Fabius dhe z. Tabuteau, kryetarja vuri theksin edhe në nevojën e thellimit të bashkëpunimit ndër-institucional ndërmjet institucioneve përkatëse me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe të njohurive praktike në fushat me interes reciprok.

Kryetarja Caka – Nimani zhvilloi një sërë takimesh me zyrtarë të lartë të Senatit francez, të ngarkuar me çështjet politike, legjislative dhe të drejtat e njeriut për rajonin e Kosovës dhe Ballkanin Perëndimor, përfshirë Nënkryetaren e Senatit Valerie Letard dhe Senatoren Laure Darcos, që gjithashtu udhëheq grupin ndërparlamentar të miqësisë ndërmjet Francës dhe Ballkanit Perëndimor.

Kryetarja Caka – Nimani vizitën në kryeqytetin francez e përmbylli me takimin e përbashkët me kryetarin e Gjykatës së Kasacionit të Francës, z. Christophe Soulard, me të cilin ndërmjet tjerash diskutuan përkitazi me sfidat në procedurat e kontrollit kushtetues dhe interpretimin uniform të ligjeve në të dyja vendet dhe për mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen ndërmjet dy Gjykatave.

I. Vizitat zyrtare në Gjykatën Kushtetuese/Aktivitete të tjera

21 janar 2022

Në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës u mbajt punëtorja përkitazi me rolin dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, si dhe raportin e saj me gjykatat e rregullta dhe institucionet e tjera në vend. Punëtorja u organizua me iniciativë të Akademisë së Drejtësisë të Kosovës dhe në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese, në kuadër të programit të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar.

Gjatë punëtorisë së mbajtur, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, z. Nexhmi Rexhepi, i njoftoi gjyqtarët e rinj më për së afërmi me rolin, funksionin dhe juridiksionin që ka Gjykata Kushtetuese në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, si dhe për marrëdhëniet me gjyqësorin e rregullt dhe procedurat e trajtimit të lëndëve nga gjyqtarët kushtetues.

Gjyqtari Rexhepi i informoi gjyqtarët e sapoemëruar edhe për mundësitë që ofron kontrolli incidental, përkatësisht e drejta që gëzojnë gjykatat e rregullta për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesat që kanë të bëjnë me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji që mund të jetë kontestuar gjatë procedurës gjyqësore.

18 shkurt 2022

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani dhe ambasadorja e Francës në Kosovë, shkëlqesia e saj, znj. Marie – Christine Butel, kanë nënshkruar bashkë me “Aleancën Franceze” të Prishtinës një Memorandum që u mundëson gjyqtarëve dhe zyrtarëve të Gjykatës të ndjekin kurse të gjuhës frënge.

Gjatë ceremonisë së nënshkrimit në Gjykatë, kryetarja Caka-Nimani falënderoi ambasadoren Butel për mbështetjen e saj të vazhdueshme, duke theksuar përgjegjshmërinë e “Aleancës Franceze” në hartimin e një oferte të trajnimit gjuhësor koherent me nevojat e Gjykatës Kushtetuese. Përforcimi i kapaciteteve profesionale dhe gjuhësore të gjyqtarëve të saj është prioritet për Gjykatën, dhe kjo kontribuon në përforcimin e sundimit të ligjit në Kosovë, përmes lidhjeve gjithnjë e më të forta në mes të Francës dhe Kosovës.

22 shkurt 2022

Me mbështetjen e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar “IRZ”, Gjyqtarët dhe këshilltarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, morën pjesë në punëtorinë e përbashkët lidhur kontrollin incidental, përkatësisht mundësinë e gjykatave të rregullta që të ngritin në Gjykatën Kushtetuese çështje të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, kur një çështje e tillë ngritet gjatë procedurave gjyqësore.

Punëtorja e organizuar nëpërmjet video-konferencës dhe u moderua nga ish-gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë dhe profesoresha e së drejtës publike në Universitetin e Bielefeldit, znj. Gertrude Lübke-Wolff dhe z. Michael Eichberger, ish-gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë dhe profesor nderi në Universitetin Eberhard-Karls të Tübingenit

11 mars 2022

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim një delegacion nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga anëtarët e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratë Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Fillimisht, kryetarja Caka – Nimani e njoftoi delegacionin nga Shqipëria me përbërjen dhe me strukturën organizative të Gjykatës, me mënyrën e funksionimit dhe me punën e deritanishme, si dhe me sfidat që përballen aktualisht ky institucion.

Gjatë bashkëbisedimit, kryetarja Caka – Nimani vuri theksin në marrëdhëniet jashtëzakonisht të mira të bashkëpunimit me Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë dhe me mbështetjen që kjo gjykatë i ka ofruar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës veçanërisht në vitet e para pas themelimit.

1 prill 2022

Studentët e “Klubit të Etikës” të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, qëndruan për vizitë në Gjykatën Kushtetuese. Ata u pritën në takim nga gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, e cila i njoftoi studentët shkurtimisht përkitazi me rolin dhe funksionin që ka Gjykata Kushtetuese, për përbërjen e saj ndërkombëtare në vitet e para të funksionimit, si dhe për juridiksionin që ka në trajtimin e çështjeve të ndryshme kushtetuese të parashtruara.

Palët e autorizuar për parashtrimin e ankesave kushtetuese, e drejta e referimit të kërkesave nga gjyqësori i rregullt nëpërmjet mekanizmit të kontrollit incidental dhe vendimmarrja e Gjykatës bazuar në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ishin gjithashtu temë e prezantimit të gjyqtarës Gërxhaliu-Krasniqi.

5 prill 2022

Gjykata Kushtetuese organizoi aktivitetin “Dita e Gjykatës së Hapur”, të premten, më 8 prill 2022. Ky aktivitet, që nga ky vit do të mbahet çdo të premten e parë të muajit prill, organizohet me qëllim të vetëdijesimit dhe informimit më të mirë të opinionit publik për rolin dhe funksionin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe për rritjen e nivelit të transparencës ndaj publikut.

Në këtë ditë, qytetarët e vendit, e veçanërisht studentët e drejtësisë, përfaqësues të komunitetit juridik dhe vizitorët e tjerë, do të kenë mundësi që të vizitojnë objektin e Gjykatës Kushtetuese dhe të njihen më për së afërmi me Gjykatoren, me Bibliotekën dhe me ambientet në të cilat punojnë gjyqtarët dhe zyrtarët e Gjykatës, si dhe të informohen drejtpërsëdrejti përkitazi me historikun, me punën e deritanishme dhe me kompetencat kushtetuese të këtij institucioni.

6 prill 2022

Studentët e nivelit master të Fakultetit Juridik të Universitetit “Hasan Prishtina” vizituan Gjykatën. Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim studentët e nivelit master të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, të shoqëruar nga profesori universitar Visar Morina.

Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese, mekanizmat e kontrollit kushtetues, burimet e së drejtës dhe metodat e interpretimit, raporti ndërmjet Kushtetutës së vendit dhe instrumenteve ndërkombëtare, si dhe zbatimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimmarrjen e Gjykatës, ishin vetëm disa prej temave në të cilat kryetarja Caka – Nimani fokusoi prezantimin e saj para studentëve.

7 prill 2022

Një grup studentësh të drejtësisë, të shoqëruar nga menaxheri i projekteve të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), z. Yll Zekaj, qëndruan për vizitë në Gjykatën Kushtetuese. Ata u pritën në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka – Nimani dhe këshilltari i parë i Gjykatës, z. Jeton Bytyqi.

Gjatë takimit me studentë, kryetarja Caka – Nimani bëri një prezantim të shkurtër përkitazi me strukturën organizative të Gjykatës, palët e autorizuarra për parashtrimin e kërkesave, procedurat e regjistrimit dhe afatet e shqyrtimit të lëndëve, si dhe procesin e përgatitjes së raporteve paraprake nga këshilltarët dhe gjyqtarët e rastit.

12 prill 2022

Gjyqtarët dhe zyrtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të udhëhequr nga kryetarja, znj. Gresa Caka – Nimani, morën pjesë në Konferencën lansuese të projektit të Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, “Mbështetje për Gjykatën Kushtetuese në aplikimin dhe përhapjen e standardeve evropiane të të drejtave të njeriut”, e cila u mbajt në hotelin “Swiss Diamond Hotel” në Prishtinë.

Me një fjalë rasti, pjesëmarrësve në këtë konferencë iu drejtuan kryetarja Caka – Nimani, shefi i Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, z. Frank Power, ambasadori i Italisë në Kosovë, z. Antonello De Riu, zëvendës shefja e Misionit të Ambasadës së Norvegjisë në Kosovë, znj. Jenny Stenberg Sør vold dhe z. Christophe Poirel, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit në Këshillin e Evropës.

Pasi që shprehu falënderimin e saj për mbështetjen që Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë i ka ofruar Gjykatës Kushtetuese ndër vite, kryetarja Caka – Nimani, ndër të tjera, vuri theksin në rëndësinë që ky projekt ka për konsolidimin e mëtutjeshëm të praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të bazuar në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), për praktikën hulumtuese dhe procesin e punës së Gjykatës Kushtetuese sipas shembullit të GJEDNJ-së, si dhe për zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës.

28 prill 2022

Nxënësit e gjimnazit “Sami Frashëri” në Prishtinë qëndruan për vizitë në Gjykatën Kushtetuese, të cilët në takim u pritën nga drejtori i Zyrës për Komunikim dhe Informim, z. Veton Dula.

Historiku i themelimit dhe struktura organizative e Gjykatës, përbërja ndërkombëtare dhe ajo aktuale e gjyqtarëve kushtetues, mënyra e parashtrimit të kërkesave dhe llojet e vendimeve që i nxjerrë kjo Gjykatë, si dhe raporti me gjykatat e niveleve të tjera në vend dhe marrëdhëniet e saj me Komisionin e Venecias, ishin ndër temat e trajtuara në prezantimin e z. Dula para gjimnazistëve prishtinas.

Mundësitë e procedimit të lëndëve në afat më të shkurtër kohor, palët e autorizuarra për parashtrimin e kërkesave, kriteret e përzgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues dhe e drejta apelimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ishin vetëm disa ndër çështjet për të cilat nxënësit e gjimnazit “Sami Frashëri” shprehën interesimin që të informohen më shumë.

16 maj 2022

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me përkrahjen e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar “IRZ”, organizoi konferencën e përbashkët me Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë, dhe me Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, në temën: *“Ndërveprimi i juridiksionit gjyqësor dhe kushtetues për garantimin e shtetit të së drejtës: Përvoja nga Kosova, Shqipëria dhe Gjermania”*.

Kjo është konferenca e parë e përbashkët e kësaj natyre që organizohet ndërmjet gjykatave simotra të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, e cila do të mbahet në “Hotel Emerald” në Prishtinë, më 17 dhe 18 maj 2022, me fillim në ora 09:30.

Krahas gjyqtarëve nga Kosova dhe Shqipëria, prezantues në këtë konferencë dhe njëherësh moderator i një prej paneleve për diskutim, do të jetë edhe ish-gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, Prof. dr. Reinhard Gaier.

7 qershor 2022

Në punëtorinë e organizuar me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, me temë: *“Kontestet Zgjedhore dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*, gjyqtarët dhe këshilltarët juridik të Gjykatës Kushtetuese patën rastin që të njihen më për së afërmi me standardet e përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në lidhje me kontestet zgjedhore dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në këtë fushë.

E drejta për të votuar dhe për t’u kandiduar në zgjedhje, administrimi i zgjedhjeve dhe mosmarrëveshjet paszgjedhore në këndvështrimin krahasues, si dhe zbatimi praktik i nenit 3 të Protokollit 1 të KEDNJ-së në rastin e mosmarrëveshjeve zgjedhore, ishin ndër temat kryesore mbi të cilat ekspertë ndërkombëtar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni i Venecias shprehën pikëpamjet e tyre.

25 shtator 2022

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Remzije Istrefi – Peci, pritën në takim të përbashkët një grup studentësh ndërkombëtar të Programit Evropian (EMA) për studime pasuniversitare në fushën e të drejtave të njeriut dhe demokratizim, nga kampuset universitare në Vjenë dhe Venedik.

Gjatë prezantimit të tyre, kryetarja Caka – Nimani dhe gjyqtarja Istrefi – Peci fillimisht i informuan studentët me historikun e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe obligimin kushtetues për respektimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me rolin dhe funksionin e Gjykatës Kushtetuese në sistemin shtetëror të Republikës së Kosovës, si dhe me sfidat me të cilat është ballafaquar deri më tani kjo gjykatë në punën e saj.

Në vijim të takimit, studentët shprehën interesimin e tyre që të informohen më hollësisht përkitazi me respektimin e Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Kulture dhe Sociale në nivel vendi, me procesin e parashtrimit të kërkesave individuale në Gjykatë, për numrin e parashtrimit të kërkesave nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë dhe publikimin e vendimeve në gjuhët e tyre, si dhe për respektimin dhe zbatimin e vendimeve të Gjykatës.

29 shtator 2022

Në kuadër të programit trajnues të organizuar nga OJQ “Grupi për Ballkan”, me temë: *“Të rinjtë në Politikë: Qeverisja dhe Sistemet Politike”*, aktivistë të forumeve rinore të partive politike të Kosovës vizituan Gjykatën Kushtetuese.

Ata u pritën në takim nga gjyqtarët, znj. Selvete Gërxhaliu – Krasniqi dhe z. Nexhmi Rexhepi, të cilët gjatë prezantimit të tyre diskutuan mbi rolin dhe rëndësinë e Gjykatës Kushtetuese në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, për përbërjen e parë dhe aktuale të gjyqtarëve

kushtetues, për raportin me gjykatat e rregullta dhe organet e tjera shtetërore në vend, si dhe për palët e autorizuar për parashtrimin e ankesave kushtetuese.

Gjatë takimit, politikanët e rinj shprehën interesimin e tyre që të informohen më në detaje përkitazi me llojet e vendimeve që nxjerrë Gjykata, për procesin e votimit dhe kuorumin e nevojshëm për vendimmarrjen e gjyqtarëve, për natyrën e kërkesave kushtetuese dhe numrin e tyre, si dhe për mundësitë e ankimimit ndaj vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

24 - 25 tetor 2022

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës mbajti punëtorinë mbi Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese, më 24 - 25 tetor 2022, në Prishtinë.

Punëtoria është mbështetur nga programi i USAID-it “Chemonics”, duke mbështetur Gjykatën me Gjyqtarin Federal të Shteteve të Bashkuara, John Tunheim. Gjyqtari Tunheim ka moderuar punëtorinë dhe ka ofruar ekspertizën e tij përgjatë diskutimeve të kësaj punëtorie.

11 nëntor 2022

Një grup studentësh të viteve të fundit të fakulteteve juridike nga universitetet anembanë vendit, të shoqëruar nga përfaqësues të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), qëndruan për vizitë në Gjykatën Kushtetuese.

Studentët u pritën në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe Juriskonsulti i Gjykatës, z. Sevdail Kastrati.

Rolin dhe funksioni që ka Gjykata Kushtetuese në sistemin shtetëror të Republikës së Kosovës, përbërja e saj në vitet e para të funksionimit me gjyqtarë dhe staf ndërkombëtar, burimet e së drejtës kushtetuese dhe shterja e mjeteve juridike para dorëzimit të kërkesave në Gjykatë, ishin vetëm disa ndër temat për të cilat kryetarja Caka – Nimani diskutoi para studentëve.

21 - 22 nëntor 2022

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Mbështetje për Gjykatën Kushtetuese në zbatimin dhe përhapjen e standardeve evropiane për të drejtat e njeriut”, është mbajtur punëtoria e II për Gjyqtarë dhe Këshilltarë Ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht mbi temën: *“Procedimi efektiv i rasteve të dhunës kundër femrave dhe rasteve të dhunës në familje – standardet dhe praktika evropiane”*, më 21-22 nëntor, në Prishtinë.

9 dhjetor 2022

Gjykata Kushtetuese organizoi aktivitetin “Dita e Gjykatës së Hapur”, më 9 dhjetor 2022, në shënim të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

Ky aktivitet, u organizuar me qëllim të vetëdijesimit dhe informimit më të mirë të opinionit publik për rolin dhe funksionin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe për rritjen e nivelit të transparencës ndaj publikut.

Në këtë ditë, qytetarët e vendit, e veçanërisht studentët e drejtësisë, përfaqësues të komunitetit juridik dhe vizitorët e tjerë, do të kenë mundësi që të vizitojnë objektin e Gjykatës Kushtetuese dhe të njihen më për së afërmi me Gjykatoren, me Bibliotekën dhe me ambientet në të cilat punojnë gjyqtarët dhe zyrtarët e Gjykatës, si dhe të informohen drejtpërsëdrejti përkitazi me historikun, me punën e deritanishme dhe me kompetencat kushtetuese të këtij institucioni.

9 dhjetor 2022

Me rastin e “Dita e Gjykatës së Hapur”, organizuar në shënim të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Gjykatën Kushtetuese e vizituan studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, një grup qytetarësh dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë.

Studentët u pritën në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka – Nimani, e cila gjatë prezantimit të saj bëri një përshkrim të shkurtër të historikut të themelimit të Gjykatës, të përbërjes së parë me gjyqtarë dhe zyrtarë ndërkombëtarë, krahas atyre vendor, si dhe për sfidat e përballura gjatë trajtimit të çështjeve të ndryshme kushtetuese, mbi të cilat edhe janë vënë themelet e gjyqësisë kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Në vijim të prezantimit të saj, kryetarja Caka – Nimani foli edhe për rëndësinë që ka në nivel global Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, si dhe për respektimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe zbatimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çdo vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Në “Ditën e Gjykatës së Hapur”, kryetarja Caka – Nimani, e shoqëruar nga gjyqtarja Selvete Gërzhaliu – Krasniqi, pritën në vizitë edhe një grup juristësh dhe praktikantësh të angazhuar në kuadër të projektit “Just React” të organizatës joqeveritare “Grupi për Studime Juridike dhe Politike”, për monitorimin e punës së gjykatave të rregullta në Republikën e Kosovës.

5 - 16 dhjetor 2022

Ekspertja amerikane me përvojë të gjatë në fushën e komunikimit të brendshëm dhe zhvillimit organizativ, dhe njëherësh ligjëruese në Universitetin e Kolumbias të SHBA, Prof. Dr. Aileen Webb, qëndroi për vizitë në Gjykatën Kushtetuese, më 5 - 16 dhjetor 2022.

Përgjatë qëndrimit gati dyjavor në Gjykatë, znj. Webb zhvilloi dhe zbatoi në praktikë një program të avancuar të trajnimit, të dizajnuar veçanërisht për zyrtarët e Gjykatës Kushtetuese, përmes shtjellimit të temave si: “Ekipet e mira dhe kultura organizative”, “Komunikimi dhe konflikti”, “Ndërtimi i ekipeve dhe i besimit”, “Ndryshimi dhe komunikimi” dhe “Takimet e shkëlqyera”. Gjatë trajnimeve të mbajtura, znj. Webb ndau njohuritë e saj teorike dhe praktike, me qëllim të ndërtimit të vlerave dhe parimeve të organizimit të mirë dhe funksional brenda një institucioni, me theks të veçantë në metodat më të mira për ndërtimin e besimit të ndërsjellë, si dhe mekanizmat e komunikimit dhe të llogaridhënies brenda ekipeve.

Programi i trajnimit në përgjithësi pati si synim pajisjen e zyrtarëve të Gjykatës me njohuritë dhe aftësitë bazë për të zgjidhur sfidat që pashmangshëm paraqiten në një ambient të përbashkët pune. Secila prej punëtorive ishte konceptuar të jetë ndërvepruese dhe të nxisë pjesëmarrjen aktive të stafit, duke përdorur një varg teknikash të kombinuara si rastet studimore, ushtrimet në grupe të vogla, diskutimet në grup të gjerë dhe reflektimi individual.

Ky program i ngritjes së kapaciteteve të stafit të Gjykatës u mundësua përmes mbështetjes nga “Programi i Specialistëve të Fulbright”, financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Byroja për Edukim dhe Marrëdhënie Kulturore (ECA) dhe zbatuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. Gjykata ka përfituar këtë mbështetje pas një procesi të hapur konkurrues dhe miratimit të projekt-propozimit të saj.

20 - 21 dhjetor 2022

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Mbështetje për Gjykatën Kushtetuese në zbatimin dhe përhapjen e standardeve evropiane për të drejtat e njeriut”, u mbajt punëtorja e III për Gjyqtarë dhe Këshilltarë Ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht mbi temën: *“Mjetet Juridike Efektive – Standardet dhe Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*, më 20 - 21 dhjetor, në Prishtinë.

SHTOJCA I

SHTOJCA I

Përmbledhje e llogarive të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2022
Pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme

Shën.	2022			2021			2020		
	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme
	BKK	THV		BKK	THV		BKK	THV	
	€	€	€	€	€	€	€	€	€
Pranimet									
Ndarjet nga Fondi i përgjithshëm	1,825,629			1,958,128			1,886,805		
Të hyrat vetanake									
Ndarjet nga Fondi me qëllime të dedikuara									
Grantet e përcaktuara të donatorëve									
Fondi i huazimeve									
Pranimet e tjera									
Totali i pranimeve	1,825,629	-		1,958,128	-	-	1,886,805	-	-
Pagesat									
Operacionet									
Pagat dhe mëditjet	2	1,209,699		1,296,201			1,290,541		
Mallrat dhe shërbimet	3	541,634		546,106			378,505		
Shërbimet komunale	4	2,750		2,583			2,464		
		<u>1,754,083</u>		<u>1,844,890</u>			<u>1,671,509</u>		
Transferet									
Transferet dhe subvencionet	5	71,546							
Shpenzimet kapitale									
Prona, ndërtesa dhe pajisjet	6								
Kthimi				113,238			215,296		
Huamarrjes	7								
Pagesat e tjera	8								
Pagesat gjithsej	1,825,629	-		1,958,128	-	-	1,886,805	-	-

Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit

	Shënime	2022				2021	2020
		Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Dallimi	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=C-B	E	F
		€	€	€	€	€	€
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Të hyrat tatimore	9						
Të hyrat jo tatimore	10						
Të hyrat dedikuara	11						
Grantet dhe ndihma	12						
Huamarrje	13						
Tjera	14						

Pranimet totale të mbledhura për BKK		-	-	-	-	-	-
--------------------------------------	--	---	---	---	---	---	---

Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit							
Pagat dhe mëditjet	2	1,388,837	1,388,837	1,209,699	179,138	1,296,201	1,290,541
Mallrat dhe shërbimet	3	487,356	565,856	541,634	24,222	546,106	378,505
Shërbimet komunale	4	4,000	4,000	2,750	1,250	2,583	2,464
Transferet dhe subvencionet	5	91,080	77,580	71,546	6,034		
Shpenzimet kapitale	6	110,000	45,000		45,000	113,238	215,296
Fondi i privatizimit	7						
Të tjera	8						
Totali i pagesave të bërë nga BKK		2,081,273	2,081,273	1,825,629	255,644	1,958,128	1,886,806

Ndarjet e fondit të përgjithshëm për vitin 2022

Klasifikimi ekonomik	2022			2021	2020
	BKK	THV	Totali		
	€	€	€	€	€
Pagat dhe mëditjet	1,388,837		1,388,837	1,296,201	1,290,541
Mallrat dhe shërbimet	565,856		565,856	546,106	378,505
Shërbimet komunale	4,000		4,000	2,583	2,464
Subvencionet dhe transferet	77,580		77,580		
Shpenzimet kapitale	45,000		45,000	113,238	215,296
	2,081,273	-	2,081,273	1,958,128	1,886,806

ORGANOGRAMI



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

USTAVNI SUD

CONSTITUTIONAL COURT

